



PËRFUNDON FAZA E KATËRT E PASTRIMIT



FA, shpalsën vlera të larta të atdhetarisë dhe të bashkëjetesës në komunitet

Ministrja Kodheli: Ky vend ka nevojë për projekte, por edhe për të forcuar më shumë frymën qortuese
faqe 4

QNOD

Peshkimi, synohet rritja e sigurisë në det dhe zbatimin i ligjshmërisë

faqe 12

NDËRKOMBËTARE

"Ne kemi vendosur të gjithë gamën e bashkëpunimit NATO-Rusi në shqyrtim"

Rasmussen në konferencën për shtyp, pas mbledhjes së Këshillit NATO-Rusi
faqe 5

VIZITA



Diskutohet mbi draft-marrëveshjen për unifikimin e arsimimit e trajnimit

Komandanti i KDS-së së Kosovës, gjeneral-brigade Enver Cikaqi kryen një vizitë pune në institucionin e KDS së FARSH
faqe 3

PËRKUJTOHET 570-VJETORI I KUVENDIT TË LEZHËS

Ministrja Kodheli: Gjergj Kastrioti i 1444-ës bëri atë që vetëm Garibaldi e Bismarku ditën të bëjnë në vitet '800

Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Meta: Mesazhi më i rëndësishëm i Besëlidhjes së Lezhës, 'Bashkimi bën fuqinë'



faqen 2

MAT, tregon shkallë të lartë cilësie dhe ambicie të FARSH

"Military Advisor Team-5" niset me mision në Afganistan

Qëllimi i këtij misioni, me ushtarakë shqiptarë dhe amerikanë, është asistenca në trajnimin e Brigadës së Parë të Motorizuar të FA afgane



faqen 3

FLET MARI SKAARE, PËRFAQËSUESJA SPECIALE E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË NATO-S

Perspektiva gjinore dhe FA në këndvështrimin e NATO-s



Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Grave, Përfaqësuesja Speciale e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, për Gratë, Paqen e Sigurinë, zj. Mari Skaare, iu përgjigj pyetjeve për implementimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit...
faqe 8-9

ANALIZA

Konflikti ukrainas - një duel i hapur midis BE dhe Ruisë

faqe 7

ARSIMIMI

Në kërkim të modelit të arsimimit

faqe 10-11

GJEOPOLITIKA

Ukraina, fat i parathënë nga gjeografia...

faqe 13

FORCA TOKËSORE



Emërimet e reja në FT, premtojnë vazhdimësi dhe ndryshime pozitive

Zhvillohet ceremonia e emërimeve të komandantëve të Batalionit të Dytë të Këmbësorisë dhe të Batalionit Komando

faqe 6

Përkujtohet 570-vjetori i Kuvendit të Lezhës

Ministrja Kodheli: Gjergj Kastrioti i 1444-ës bëri atë që vetëm Garibaldi e Bismarku ditën të bëjnë në vitet '800

Në qytetin historik të Lezhës është kremtuar në datën 2 mars 2014 570-vjetori i Kuvendit të

Lezhës. Me këtë rast pranë Mauzoleut të heroit kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu u zhvillua një ceremoni e veçantë ku ishin të pranishëm: kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Ilir Meta, ministrja Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, kryetari Bashkisë së Lezhës, z. Viktor Tusha, përfaqësues të trupit diplomatik të akredituar në vendin tonë, përfaqësues të komuniteti fetar, si dhe mjaft qytetarë të Lezhës. Ministrja e Mbrojtjes Kodheli, në emër të qeverisë shqiptare, ka mbajtur përshëndetjen e rastit. “Bashkim si Besëlidhja e Lezhës, Evropa do ta shihte përsëri vetëm 4 shekuj më vonë. Pa modesti, mund të themi me plot gojën se Gjergj Kastrioti i 1444-ës bëri atë që vetëm Garibaldi e Bismarku ditën të bëjnë në vitet '800”.

“Bashkim si Besëlidhja e Lezhës, Evropa do ta shihte përsëri vetëm 4 shekuj më vonë. Pa modesti, mund të themi me plot gojën se Gjergj Kastrioti i 1444-ës bëri atë që vetëm Garibaldi e Bismarku ditën të bëjnë në vitet '800”.



Fjala ministres së Mbrojtjes, Mimi Kodheli

“Bashkim si Besëlidhja e Lezhës, Evropa do ta shihte përsëri vetëm 4 shekuj më vonë”

Sot ne jemi mbledhur të gjithë këtu në përvjetorin e 570-të, të Kuvendit të Lezhës. Ne të gjithë e dimë rëndësinë e kësaj ngjarje historike për mbarë vendin, të cilin ne sot e gëzojmë. Gjendemi shpesh në përkujtime të tilla, për data, vende dhe ngjarje të cilat janë për gjithë ne shqiptarët momente reflektimi dhe frymëzimi për atë që bëjmë përditë. Me Besëlidhjen e Lezhës lidhet një pjesë e mirë e ndërgjegjes sonë individuale e shoqërore. Jemi rritur duke dëgjuar dhe admiruar historinë, duke imagjinuar personazhet dhe duke lexuar apo mësuar atë që ndodhi atë 2 mars të 1444-ës. Shqiptarët, 570 vjet më parë vendosën të gjithë së bashku të bashkoheshin për të qenë kufiri i vortë i europianizmit përballë obskurantizmit lindor. Shqiptarët lanë mënjanë ndasitë politike e krahinore për t'ju kundërvënë rrezikut të përbashkët që rrekej të shkëpuste trojet e Arbrit nga vetëdija evropiane. Bashkimi i feudaleve arbër përmbi interesat e tyre direkt, në atë mars të largët 570 vjet më parë, cilësohet si një lëvizje e paprecedent për Evropën e shekullit të 15-të. Bashkim si Besëlidhja e Lezhës, Evropa do ta shihte përsëri vetëm 4 shekuj më vonë. Pa modesti, mund të themi me plot gojën se Gjergj Kastrioti i 1444-ës bëri atë që vetëm Garibaldi e Bismarku ditën të bëjnë në vitet '800. Në këtë Kuvend ata burra morën një vendim madhor: që të nisnin luftën dhe të mbronin vendin. Ajo ishte besëlidhja e tyre. Ne sot kemi një luftë të njëjtë në parim, jo kundër armikut, por një luftë për një të ardhme më të mirë. Një luftë për një të ardhme më të denjë për brezat tanë. Një të ardhme më të sigurt për fëmijët tanë. Mesazhet e Kuvendit të Lezhës janë kurdoherë aktuale, për faktin se na thërrasin për bashkim, na ftojnë për unitet dhe na bashkojnë për një të ardhme më të mirë në familjen evropiane”, - nënvizoi ndër të tjera ministrja Kodheli. Ndërsa në fjalën e tij, Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Ilir Meta, tha ndër të tjera: “Popujt e vegjël nuk kanë shumë çaste krenarie në histori. Ne shqiptarët jemi me fat, sepse kemi disa të tilla. Kemi Besëlidhjen e Lezhës, kemi Lidhjen e Prizrenit, kemi Kuvendin e Pavarësisë së Vlorës, kemi Konferencën e Pezës, kemi epopenë e Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare, prandaj kur krahasohemi me maja të tilla historike ne mund të kuptojmë më mirë të sotmen tonë dhe mund të projektojmë më ndershëmrisht të nesërmen tonë të përbashkët”. Mes vlerësimeve të paraardhësve, mesazheve të dhëna për realitetin e sotëm dhe një ambienti festiv, u zhvillua ky aktivitet përkujtimor në qytetin e Lezhës. Gjatë kësaj ceremonie përkujtimore ministrja Kodheli vendosi një kurorë me lule pranë varrit të heroit kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

Fjala e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, z. Ilir Meta

“Mesazhi më i rëndësishëm i Besëlidhjes së Lezhës: Bashkimi bën fuqinë”

Sot nuk mund të mungojë në këtë ngjarje kaq të rëndësishme këtu në Lezhë, në këtë përvjetor të 570 të Kuvendit të parë të shqiptarëve. Këtu në këtë vend të shenjtë për Shqipërinë dhe për të gjithë shqiptarët në të gjitha kohët. Këtu ku është varri monumental i Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriotit. Këtu ku është djepi i ngjarjes më të madhe të historisë sonë, ku u lidh besa 570 vjet më parë, midis gjithë prijësve arbërorë për të realizuar aktin më të rëndësishëm, atë të bashkimit të tyre, në të njëjtin flamur, dhe nën të njëjtin besim, me të njëjtin qëllim dhe nën një udhëheqës të vetëm. Ata u bënë bashkë këtu në Lezhë përballë kërcënimit të superfuqisë së kohës. Perandorisë Osmane, përballë këtij kërcënimi madhor, përgjigja ishte një, krijimi i Besëlidhjes Arbërore me në krye Gjergj Kastriotin. Kurajoja arbërore u bë vatra e ndezur e shpresës, atëherë kur përreth shpresa ngjante e shuar. Kurajoja arbërore u shndërrua në ishullin e lirisë në mes gadishullit të pushtuar. Kurajoja arbërore u kthye në portin nga ku anijet osmane nuk mundën të nisen dot kurrë drejt zemrës së Evropës dhe Perëndimit, atje ku mbretëronte kryqi i Krishtit. U bë pragu që nuk lejoi kapërcimin e Adriatikut. Qëndresa arbërore u bë shpata dhe mburoja e qytetërimit evropian që kërcënohej nga forca dhe zjarri i një besimi tjetër që vinte nga larg, nga një tjetër kulturë, nga një tjetër qytetërim që ishte i huaj për Evropën e Mesjetës. Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Princi i parë mes të barbartëve, u shndërrua në portën e çelikut që mbajti pas terrin që donte të sillte zgjerimin e Lindjes së huaj në Perëndim. Ky njeri i madh i Mesjetës, ky kalorës i jashtëzakonshëm i krishterimit, ka qenë dhe do të mbetet në të gjitha kohërat krenaria dhe frymëzimi ynë më i madh kombëtar. Ideja e tij e jashtëzakonshme e bashkimit të Principatave të copëtuara feudale ndodhi shumë kohë më parë, madje, edhe para se të ndodhte në vende të tjera të Evropës. Mesazhi më i rëndësishëm i Besëlidhjes së Lezhës, që i flet ende në shqip të gjitha kohërave tona shqiptarët, si çdo komb tjetër në historinë e vjetër dhe moderne të botës, kanë dëshmuar se mund të jenë të fortë dhe se mund të realizojnë aspiratat e tyre dhe Lezha e Besëlidhjes bëri bashkë Arianitasit dhe Dukagjinastit, Balshajt, Muzakajt dhe Topiajt, i bëri bashkë të gjithë princat hijerëndë të asaj kohe të rëndë, i bëri bashkë nën një komandë të vetme, nën një qëllim të vetëm, nën një flamur të vetëm, atë të lirisë. 25 vjet beteja dhe fitore që tronditën perandorinë më të madhe të kohës u bënë në historinë e këtij vendi burimi i frymëzimit dhe pika e referimit për çdo rizgjim të ndjenjave kombëtare, për çdo përpjekje për të rifituar lirinë. Pak më shumë se katër shekuj mbas këtij diamanti të paçmuar të historisë sonë, shqiptarët e mençur dhe patriotë e tentuan të bëjnë përsëri këtë gjë, bashkimin për të arritur lirinë, përballë të njëjtët pushtues, Perandorisë Osmane. Lidhja Shqiptare e Prizrenit e vitit 1878 kërkoi rizgjimimin e vetëdijes kombëtare me mbledhjen e mbi 300 përfaqësuesve të të gjitha krahinave shqiptare, që kërkonin formimin e një shteti autonom shqiptar që do të mbulonte të gjitha vilajetet e asaj kohe. Po kështu pak më vonë, Kuvendi i Vlorës me në krye një tjetër shqiptar të madh, Ismail Qemalin, do ta shpallte Shqipërinë “më vehte, të lirë e të mosvarme” nën flamurin e Gjergj Kastrioti Skënderbeut. Në këtë botë të pafundme, ne shqiptarët jemi shumë pak për të qenë të ndarë, në këtë botë të pafundme, ne shqiptarët bëhemi shumë kur dimë të bëhemi bashkë përballë një armiku dhe një rreziku që na kërcënon të gjithëve bashkë në identitetin tonë dhe në lirinë tonë. Të bashkuar pa dallim feje, krahine dhe ideje ishte nën shembullin e Besëlidhjes së Lezhës edhe parrulla e konferencës së Pezës, e shatorit të vitit 1942. Të bashkuar përpara pushtimit dhe kërcënimit antifashist. Ky ishte një ndër aktet historike që kërkonte t'i bënte bashkë shqiptarët në luftën kundër barbarisë, aleatë të vendosur në një ndeshje për jetë e vdekje, që bëhej nga veriu i Evropës e deri në stëpat ish-sovjetike, që digjej me zjarr e hekur nga njëra anë e Atlantikut e deri në skajin tjetër të Paqësorit. Shqipëria dhe shqiptarët ditën nën shembullin e Besëlidhjes së Lezhës, të realizonin Konferencën e Pezës dhe të rreshtoheshin në koalicionin e madh e fitues të asaj kohe, duke realizuar edhe rikthimin e pavarësisë së vendit dhe mbrojtjen e integritetit të tij. Në këtë vit Shqipëria do të festojë edhe 70-vjetorin e çlirimit të vendit, që do të jetë një tjetër shenjë e fortë e respektit dhe të mirënjohjes sonë për të gjithë ata që bënë më të mirën për të mbrojtur vlerat e rinisë dhe krenarinë tonë kombëtare. Popujt e vegjël nuk kanë shumë çaste krenarie në histori. Ne shqiptarët jemi me fat, sepse kemi disa të tilla. Kemi Besëlidhjen e Lezhës, kemi Lidhjen e Prizrenit, kemi Kuvendin e Pavarësisë së Vlorës, kemi Konferencën e Pezës, kemi epopenë e Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare, prandaj kur krahasohemi me maja të tilla historike ne mund të kuptojmë më mirë të sotmen tonë dhe mund të projektojmë më ndershëmrisht të nesërmen tonë të përbashkët. Mund të ndërgjegjësohemi më mirë për domosdoshmërinë për të qenë të bashkuar përballë rreziqeve dhe sfidave kryesore me të cilat përballet shoqëria jonë. Vetëm kur kujtojmë përjetësinë e një figure si Gjergj Kastrioti, kujtojmë qartë përkohshmërinë dhe padobinë e inateve të vogla në politikën e sotme shqiptare, të grindjeve, të egoizmit dhe të mendje-shkurtësisë. Sot armiku kryesor i shqiptarëve është varfëria dhe papunësia, është ndarja e thellë dhe tensioni i panevojshëm politik. Këta janë armiqtë që na kërcënojnë ne në rrugën tonë për një zhvillim më të shpejtë dhe më të qëndrueshëm në interes të të gjithë qytetarëve tanë. Askush nuk është dhe nuk duhet të jetë i tepërt në përpjekjet tona për të realizuar prioritetin tonë kombëtar, të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian dhe të shndërrimit të Shqipërisë dhe shoqërisë shqiptare në një vend dhe shoqëri evropiane. Të bashkuar nën flamurin e këtij synimi ne mund të ecim më shpejt, ne mund të ecim më vendosmërisht drejt destinacionit tonë historik, sepse në fund të fundit edhe ngjarja që ne kujtojmë sot na jep këtë mesazh. Mesazhin e përpjekjeve dhe e sakrificave për të ruajtur dhe mbrojtur identitetin tonë kombëtar, por edhe evropian. Këto mesazhe vlejné mjaft edhe për Kuvendin e Shqipërisë që ai të jetë një arenë bashkimi dhe jo ndarjeje, ku jemi të ndryshëm, por jemi edhe të bashkuar shqiptarish.

“Ideja e tij e jashtëzakonshme e bashkimit të Principatave të copëtuara feudale ndodhi shumë kohë më parë, madje, edhe para se të ndodhte në vende të tjera të Evropës. Mesazhi më i rëndësishëm i Besëlidhjes së Lezhës, që i flet ende në shqip të gjitha kohërave tona shqiptare është se: bashkimi bën fuqinë.”

“Military Advisor Team-5” niset me mision në Afganistan

Qëllimi i këtij misioni është asistencë në trajnimin e Brigadës së Parë të Motorizuar të FA afgane

Është zhvilluar ditën e mërkurë, në datën 5 mars 2014, në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes ceremonia e nisjes me mision në Afganistan e kontingjentit “Military Advisor Team-5” (MAT-5). Në këtë ceremoni ishte i pranishëm shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, gjeneralë dhe ushtarakë të tjerë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm dhe Forcave të Armatosura, atashe ushtarakë të akredituar në vendin tonë, si dhe familjarë dhe të afërm të ushtarakëve pjesëmarrës në këtë mision. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Jeronim Bazo në fjalën e tij ka përshëndetur ushtarakët e këtij kontingjenti për detyrën fisnike që ata do të kryejnë, duke theksuar që FA shqiptare kontribuojnë në këtë mision së bashku me ushtarakë të Gardës Kombëtare të Nju Xhersit, SHBA. Pjesëmarrja jonë për të pestën herë në një mision të tillë trajnues është tregues i rritjes së vazhdueshme të nivelit të kontributit tonë në Afganistan. Me këtë rast, gjeneralmajor Bazo ka falënderuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës për ndihmën e vazhdueshme që kanë dhënë, duke bërë të mundur realizimin e këtij misioni shumë të rëndësishëm për asistencën në ringritjen e FA të Afganistanit. Në fund të fjalës së tij, gjeneralmajor Bazo duke iu drejtuar edhe njëherë ushtarakëve të këtij kontingjenti shprehu bindjen e tij, që “ju do të kryeni me përkushtim dhe profesionalizëm të lartë këtë mision fisnik”. Ai i drejtoi një falënderim të veçantë familjarëve të ushtarakëve paqeruajtës për mbështetjen që ata u japin djemve të tyre për të kryer me nder misionin në emër të paqes dhe të sigurisë në Afganistan. Ekipi i kontingjentit MAT-5 përbëhet nga 12 ushtarakë, në përbërje të cilit ka edhe ushtarakë të Gardës Kombëtare të Nju Xhersit. Qëllimi i këtij misioni është asistencë në trajnimin e Brigadës së Parë të Motorizuar të FA afgane. Deri tani misionet MAP kanë kontribuar në trajnime në nivele më të ulëta, deri në



Pjesëmarrja jonë për të pestën herë në një mision të tillë trajnues është tregues i rritjes së vazhdueshme të nivelit të kontributit tonë në Afganistan.

shkallë batalioni. Kontingjenti “Military Advisor Team-5” do të qëndrojë në Afganistan për një periudhë 9 mujore. Në fund të ceremonisë, shefi i Shtabit

të Përgjithshëm i FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo, i dorëzoi Flamurin Kombëtar komandantit të kontingjentit MAP-5, kolonel Ardian Bali.

Fjala e SHSHP gjeneralmajor Jeronim Bazo

“MAT, tregon shkallë të lartë cilësie dhe ambicie të FARSH”

Ajo që po bëni ju ushtarakë krenarë të FA, nuk është gjë tjetër, veç se ngritja akoma më lartë e nderit të këtij flamuri, e imazhit të FA, në fund të fundit, përmirësimi dhe lartësimi i imazhit të Republikës së Shqipërisë si anëtare e denjë e NATO-s. Është hera e pestë dhe e them me kënaqësi këtë, që ne dërgojmë për të shërbyer në Afganistan në një cilësi tepër të veçantë, së bashku me kolegët e Gardës Kombëtare të New Jersey-t për të trajnuar forcat e Sigurisë afgane krah për krah, efektivat e përgatitura të FARSH. Ajo që na bën të ndjehemi vërtet krenarë, është se është hera e pestë që ne jemi udhëheqësit e këtij misioni, gjë që e shton akoma më shumë detyrimin tuaj, së bashku me komandant Balin. Këtu gjej edhe rastin të falënderoj thellësisht SHBA, për ndihmesën e tyre të vazhdueshme që kanë bërë të mundur dërgimin për të pestën herë radhazi të këtij misioni të suksesshëm. Vetë misioni i pestë që po dërgojmë sot, që po e përcjellim sot, është një tregues i rritjes së vazhdueshme të kontributit të FA në Afganistan. E kemi nisur me ekipet që quheshin OMLT dhe sot i kemi “Military Advisor Team” (MAT). Pra është një shkallë më e lartë cilësie dhe natyrisht, që niveli i ambicies është ngritur nga niveli i një batalioni të FS afganë, në nivelin e një shtabi brigade. Kam besim të plotë, të nderuar nënoficerë, oficerë dhe komandant Bali se ju do ta kryeni me sukses këtë detyrë me përkushtimin e profesionalizmin tuaj dhe nuk më mbetet tjetër veçse t’ju uroj suksese dhe punë të mbarë. Por kam edhe një përshëndetje, një urim të veçantë, për familjarët që ju mbështesin, për mbështetjen e heshtur që ju u jepni, për sakrificën që ju përballoni, pasi pa ju do ta kishin të vështirë këta djem, do ta kishin të vështirë edhe ne. Nga ana tjetër, ju garantoj mbështetjen e vazhdueshme të MM, SHP dhe të gjithë strukturave të FA, se jemi pranë jush dhe do të qëndrojmë gjatë gjithë kohës pranë jush për t’ju mbështetur në këtë detyrë të vështirë, por edhe krenare. Zoti bekoftë Ju, Zoti bekoftë FA, Zoti bekoftë Shqipërinë!

Komandanti i KDS-së së Kosovës, gjeneral-brigade Enver Cikaqi kryen një vizitë pune në institucionin e KDS së FARSH

Diskutohet mbi draft-marrëveshjen për unifikimin e arsimimit e trajnimit

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh midis FARSH dhe FSK, në datën 28 Shkurt 2014, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërviçjes i FSK, gjeneral-brigade Enver Cikaqi, në krye të një ekipi që e shoqëronte, zhvilloi një vizitë zyrtare një ditore në Komandën e Doktrinës dhe Stërviçjes. Vizita pati si qëllim organizimin e diskutimeve mbi vendosjen e piketave të përbashkëta, në drejtim të unifikimit të arsimimit dhe trajnimit ushtarak midis dy vendeve si dhe mbi dhënien e asistencës nga pala shqiptare për integrimin e FSK në NATO. Gjeneral Cikaqi, pas pritjes me truproje nderi u prit nga zëvendëskomandanti i KDS, kolonel Ruzhdi Kuçi. Në takim ku merrnin pjesë grupet respektive të punës për diskutime të përbashkëta, Kolonel Kuçi, pasi ju uroi mirëseardhjen, e njohu Gjeneral Cikaqin dhe ekipin që e shoqëronte me zhvillimet më të fundit në FA, me ecurinë dhe zhvillimet më të fundit për përmirësimin, zhvillimin e konsolidimin e të gjithë strukturave arsimore ushtarake, në kuadër të rishikimit

e përmirësimit të procesit arsimor, programit të ri pilot të trajnimit të oficerëve të rinj nga Garda Kombëtare e New Jersey etj. Në kuadër të qëllimit që kjo vizitë kishte, kolonel Kuçi, ndër të tjerash u shpreh se: “Bashkëpunimet dypalëshe të nisura më herët, kryesisht në fushën e arsimimit ushtarak, nëpërmjet përfshirjes në kurset institucionale të oficerëve kosovarë, si në KLSM, KLO, KKSHP, kanë qenë tepër produktive. Kemi arritur në një shtysë të re të marrëdhënieve tona, me projekte ambicioze dhe të insitucionalizuara. Bashkëpunimi dypalësh do të konsolidohet në të gjitha fushat;



grupet e punës janë krijuar për këtë qëllim, si dhe për të krijuar projekte të reja në kuadër edhe të “Smart Defense”- ka përfunduar komandanti i KDS, kolonel Kuçi. Nga ana e tij, gjeneral-brigade Enver Cikaqi, u shpreh se ndajehet komod dhe falënderoi homologun e tij për mikpritjen. Gjeneral Cikaqi e njohu palën shqiptare me sistemin arsimor ushtarak që realizohet në Task-

Qendren Trajnuese të institucionit të KDS. “Shkolla ka nxjerrë e po nxjerrë kuadro shumë të përgatitur e që kanë arritur të japin impete tepër pozitive në punën e tyre. Megjithatë, shkëmbimi i ideve dhe marrja e eksperiencave tuaja në të gjitha fushat përveçse rritjes e forcimit të bashkëpunimit të përbashkët në sistemin e mbrojtjes së të dy vendeve, do i shërbejnë më së miri dhe përmirësimit dhe funksionimit pozitiv e sipas standardeve edhe të punës konkrete që bëhet në institucionin tonë, atë të Komandës dhe Doktrinës. Me përkrahjen, ndihmën sugjerimet tuaja, konsultimet e përbashkëta, do të arrijmë në një unifikim të sistemit arsimor ushtarak midis dy vendeve tone, si edhe do të jemi krah jush në arritjen e standardeve në kuadër të synimit për integrim në NATO – vijoi Gjeneral Cikaqi”. Komandanti i KDS së FSK, gjeneral Cikaqi dhe ekipi që e shoqëronte, nëpërmjet një brifingu të mbajtur nga Atasheu Ushtarak Shqiptar i akredituar në Kosovë, kolonel Figëri Hoxha, u njohën me një historik të shkurtër të bashkëpunimit Shqipëri-Kosovë në fushën e Mbrojtjes si dhe me draft marrëveshjen për unifikimin e arsimimit e trajnimit ushtarak si dhe për asistencë për integrimin në NATO të FSK, për të cilat u bënë diskutimet përkatëse.

SHSHPFA, gjeneralmajor Jeronim Bazo falënderon Forcat e Armatosura për operacionin e pastrimit

FA, shpalosën vlera të larta të atdhetarisë dhe të bashkëjetesës në komunitet

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Jeronim Bazo ka falënderuar të gjithë efektivat e Forcave të Armatosura që janë angazhuar në operacionin e pastrimit të vendit nga mbetjet urbane. “Shpreh vlerësimet maksimale për gjithë efektivat e strukturave të ndryshme të Forcave të Armatosura, të cilët për katër javë rresht janë angazhuar në pastrimin e akteve rrugore kombëtare dhe pikave kufitare. Kontributi i dhënë nga burrat dhe gratë me uniformë për një vend më të pastër, është një shembull domethënës i kulturës dhe qytetarisë, i cili duhet ndjekur nga të gjithë. Forcat e Armatosura do të vijojnë të tregojnë seriozitet dhe përkushtim në realizimin e të gjithë detyrave, duke shpalosur rishtas vlerat më të larta të atdhetarisë dhe të bashkëjetesës në komunitet”, - ka vlerësuar gjeneral Bazo.



FA kryejnë fazën e katërt të aksionit kombëtar të pastrimit

Ministrja Kodheli: Ky vend ka nevojë për projekte, por edhe për të forcuar më shumë sanksionet dhe frymën qortuese, për ngritjen e opinionit dhe të aksionit të gjithësecilit prej nesh

Data 1 mars 2014, ishte e shtuna e katërt rresht që Forcat e Armatosura, në kuadër të shpalljes së emergjencës civile për gjendjen e mjedisit nga Komisioni Ndërministror, u angazhuan në operacionin për pastrimin e territorit në shkallë vendi. 1100 trupa dhe mbi 100 mjete të strukturave të Forcave të Armatosura u përqendruan përgjatë akteve nacionale Fier-Levan-Tepelenë-Gjirokastrë-Kakavijë. Operacioni i efektiveve të Forcave të Armatosura për pastrimin e këtyre akteve nacionale është ndjekur nga afër nga ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Jeronim Bazo. Ata janë ndalur në pikën e kalimit kufitar në Kakavijë, ku forca dhe mjete ishin të angazhuar në pastrimin e segmentit rrugor dhe të territorit përreth saj. Ministra e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli ka theksuar se jemi drejt përfundimit të këtij aksioni të madh kombëtar për pastrimin e territorit nga mbetjet. Në ditën e sotme kishim mbështetjen e pushtetit lokal, të Policisë së Shtetit, të institucioneve të tjera dhe të shoqërisë civile. Në këtë kontekst, në mënyrë të veçantë ministrja Kodheli ka falënderuar median dhe opinionistët për mbështetjen që kanë dhënë gjatë këtyre ditëve për sensibilizimin e asaj që ne kemi dashur të arrijmë në përfundim të këtij aksioni: që Shqipëria, vendi ynë, të jetë më e pastër. Gjithashtu ajo ka falënderuar 1100 trupat e FA që janë



bërë edhe sot pjesë e këtij aksioni. “Ky vend ka nevojë për projekte, por edhe për të forcuar më shumë sanksionet dhe frymën qortuese, për ngritjen e opinionit dhe të aksionit të gjithësecilit prej nesh”, - ka theksuar ministrja e Mbrojtjes Kodheli. Ministra Kodheli është ndalur edhe në segmentin pranë Ujit të Ftohtë në Tepelenë, ku situata ishte mjaft problematike. Ajo edhe këtu ka inkurajuar forcat e angazhuara për

evitimin e kësaj gjendje të rënduar mjedisore dhe ka kërkuar nga institucionet përkatëse të pushtetit lokal që situata të tilla të mos lejohen në të ardhmen. Gjatë kësaj dite të shtunë janë angazhuar 1100 trupa dhe mbi 100 mjete nga strukturat e Forcave tona të Armatosura, duke bërë të mundur pastrimin e 127 km rrugë dhe transportimin me mjetet e ushtrisë të mbetjeve të nxjerra për në vendgrumbullimin e tyre.

Informacion përmbledhës mbi pjesëmarrjen e FA në pastrimin e territorit të Republikës së Shqipërisë

Në zbatim të detyrave të VKM nr. 967 datë 25.10.2013 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”, Urdhrit të Kryeministrit të RSH, nr.42 datë 06.02.2014 “Për krijimin e Task-Forcës për marrjen e masave të menjëhershme për rehabilitimin e mjedisit dhe organizimin e projektit të pastrimit të rrugëve kombëtare dhe zonave turistike nga ndotja”, Forcat e Armatosura janë angazhuar në pastrimin e territorit të RSH me moton “Shqipëria është e të gjithëve, ta mbajmë atë të pastër”. Konkretisht, strukturat e Forcave të Armatosura, në datën 08 shkurt 2014, Forcat e Armatosura u angazhuan në pastrimin e akteve rrugore kryesore si më poshtë:

1. Aksi rrugor Hani Hotit - Koplik, 15 km
2. Aksi rrugor Muriqan - Shkodër, 15 km
3. Aksi rrugor Koplik - Omaraj, 10 km
4. Aksi rrugor Ura e Bunës - Shirokë, 5 km
5. Aksi rrugor Kryebushat-Shkodër: 13 km
6. Aksi rrugor kryesor Milot - Lezhë, 16 km
7. Aksi rrugor kryqëzimi i Milotit (autostradë) - Milot, 5 km

Gjithsej nga strukturat e Forcave të Armatosura u angazhuan 1000 forca, 80 mjete dhe u krye ky volum pune:

- Pastrim aksesh rrugore, 79 km
- Transport mbetjesh 260.8 Ton
- Heqje dheu dhe lëvizje inertesh 150 m³
- Në datën 15 shkurt 2014, Forcat e Armatosura kanë kryer pastrimin e akteve rrugore kryesore si më poshtë:
- Aksi rrugor: Dogana Morinë - fundi i Urës së Drinit (kthesa Kukës) (20 km)
- Aksi rrugor: Dalja e Milotit - Rubik (12 km)
- Aksi rrugor: Milot - Kryqëzimi Kamëz, Tiranë (32 km)
- Aksi rrugor: Mbikalimi Kamëz, Tiranë - Vorë (të dyja krahët e autostradës, 12.5 km)
- Aksi rrugor: Mbikalimi Qafa e Kasharit - Aeroporti “Nënë Tereza”, Rinas (7 km)

Në total morën pjesë 1000 forca dhe 80 mjete, si dhe u krye ky volum pune:

- Pastrim aksesh rrugore, 83.5 km
- Transport mbetjesh 305.6 Ton
- Lëvizje inertesh e heqje dheu 200 m³

Në datën 22 shkurt 2014, Forcat e Armatosura kanë kryer pastrimin e akteve rrugore kryesore si më poshtë:

1. Aksi rrugor Aeroporti “Nënë Tereza” - Fushë Krujë (10 km)
2. Aksi rrugor Vorë - porti Durrës, 21 km
3. Aksi rrugor porti Durrës - Vorë, 21 km
4. Aksi rrugor Elbasan - Përrenjas, 47 km
5. Aksi Rrugor Pogradec - Korçë, (vetëm Qafë Pllaçë), 5 km
6. Aksi Rrugor Qafë Thanë - Rrajçë, 9 km
7. Aksi rrugor Korçë - Kapshticë, 30 km

Në total morën pjesë 1270 forca dhe 101 mjete, si dhe u krye ky volum pune:

- Pastrim aksesh rrugore, 143 km
- Transport mbetjesh, 633 m³
- Lëvizje inertesh e heqje dheu, 350 m³
- Në datën 01 Mars 2014, Forcat e Armatosura kanë kryer pastrimin e aksit rrugor Fier-Levan-Pika kufitare Kakavijë (127 km).

Në total morën pjesë 1050 forca dhe 92 mjete, si dhe u krye ky volum pune:

- Pastrim aksesh rrugore, 127 km
- Transport mbetjesh, 670 m³
- Lëvizje inertesh e heqje dheu, 430 m³

“Ne kemi vendosur të gjithë gamën e bashkëpunimit NATO-Rusi në shqyrtim”

Rasmussen në konferencën për shtyp të mbajtur pas mbledhjes së Këshillit NATO-Rusi në Bruksel

Situata në Ukrainë paraqet pasoja serioze për sigurinë dhe stabilitetin e zonës euroatlantike dhe Rusia vazhdon të shkelë sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës dhe angazhimet e saj ndërkombëtare. Kështu, NATO vendosi të ndërmarrë disa hapa të menjëhershëm. Ne kemi pezulluar planifikimin e misionit tonë të parë të përbashkët NATO-Rusi. Eskortën detare për anijen amerikane Cape Ray, e cila do të neutralizojë armët kimike të Sirisë. Më lejoni të theksoj se kjo nuk do të ndikojë në shkatërrimin e armëve kimike, por Rusia nuk do të përfshihet në shoqërimin e anijes amerikane. Gjithashtu, ne kemi vendosur se tani për tani nuk do të zhvillohet asnjë mbledhje civile ose ushtarake në nivel stafi me Rusinë. Ne kemi vendosur të gjithë gamën e bashkëpunimit NATO-Rusi në shqyrtim. Ministrat e Jashtëm të NATO-s do të marrin vendime lidhur me këtë në fillim të muajit prill. Këto hapa dërgojnë një mesazh të qartë: Veprimet e Rusisë do të kenë pasoja. Në të njëjtën kohë, ne do e mbajmë hapur derën për dialog politik. Pra, jemi të gatshëm të mbajmë takime ambasadorësh në Këshillin NATO-Rusi. Unë kryesova një takim të rëndësishëm të Këshillit NATO-Rusi për të diskutuar situatën në Ukrainë. Këshilli NATO-Rusi është një forum për diskutime në të gjitha çështjet, ku pati çështje mbi të cilat ramë dakord e të tjera ku nuk ramë dakord. Si kryetar i Këshillit NATO-Rusi, është detyra ime të mbështes parimet mbi të cilat është themeluar marrëdhënia jonë. Këto parime themelore tani janë në rrezik. Zotimi ynë i përbashkët për të vëzhguar me mirëbesim detyrimet tona sipas të drejtës ndërkombëtare dhe angazhimi ynë i përbashkët për t'u përbashkuar nga kërcënimet ose përdorimi i forcës ndaj njëri-tjetrit, apo ndonjë shteti tjetër. Kështu, i kërkova ambasadorëve rusë të përcjellin mesazhin e prerë të NATO-s ndaj Moskës. Në të njëjtën kohë, ne vendosëm të intensifikojmë partneritetin tonë me Ukrainën si dhe të forcojmë bashkëpunimin tonë për të mbështetur reformat demokratike. Ne do të rrisim angazhimin tonë me udhëheqjen civile dhe ushtarake ukrainase. Ne do të forcojmë përpjekjet tona për të ndërtuar kapacitetin e ushtrisë ukrainase, duke përfshirë më shumë trajnime dhe stërvitje të përbashkëta si dhe do të bëjmë më shumë për ta përfshirë Ukrainën në projektet tona shumëkombëshe për të zhvilluar aftësitë. Kjo do të plotësojë përpjekjet ndërkombëtare për të mbështetur popullin e Ukrainës ndërkohë që ata formojnë të ardhmen e tyre”.

Deklarata e Këshillit të Atlantikut të Veriut mbi situatën në Ukrainë

Këshilli i Atlantikut të Veriut dënon përshkallëzimin ushtarak të Federatës Ruse në Krime dhe shpreh shqetësimin e tij të rëndë lidhur me autorizimin e Parlamentit Rus për të përdorur Forcat e Armatosura të Federatës Ruse mbi territorin e Ukrainës.



Veprimi ushtarak kundër Ukrainës nga forcat e Federatës Ruse është një shkelje e të drejtës ndërkombëtare dhe është një kundërshtim me parimet e Këshillit NATO-Rusi dhe të Partneritetit për Paqe. Rusia duhet të respektojë detyrimet e saj sipas Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe frymën e parimet e OSBE-së, mbi të cilën qëndron paqja dhe stabiliteti në pjesën tjetër të Europës. Ne i bëjmë thirrje Rusisë të ulë tensionet.

Ne i bëjmë thirrje Federatës Ruse të respektojë angazhimet e saj ndërkombëtare, duke përfshirë ato që janë përcaktuar në Memorandumin e Budapestit në vitin 1994, Traktatin e Miqësisë dhe Bashkëpunimit ndërmjet Rusisë dhe Ukrainës në vitin 1997 dhe kornizën ligjore që rregullon prezencën e Flotës Ruse në Detin e Zi, që të tërheqë forcat në bazat e saj dhe të përmbahet nga ndërhyrjet diku tjetër në Ukrainë. Ne i bëjmë thirrje të dyja palëve që të kërkojnë menjëherë për një zgjidhje paqësore nëpërmjet dialogut dypalësh, me lehtësimin ndërkombëtar, sipas rastit dhe nëpërmjet dërgimit të vëzhguesve ndërkombëtarë nën Kujdesin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ose të Organizatës për Bashkëpunimin dhe Sigurinë në Europë (OSCE).

Ukraina është një partnere e vlefshme për NATO-n dhe një anëtare themeluese e Partneritetit për Paqe. Aleatët e NATO-s do të vazhdojnë ta mbështesin sovranitetin, pavarësinë, integritetin territorial të Ukrainës si dhe të drejtën e popullit të saj për të përcaktuar të ardhmen e tij, pa ndërhyrje nga jashtë.

Ne theksojmë rëndësinë e një procesi politik gjithëpërfshirës bazuar në vlerat demokratike, respektimin e së drejtave të njeriut, minoriteteve dhe sundimin e ligjit, i cili përmbush aspiratat demokratike të të gjithë popullit

të Ukrainës.

Ne u mbledhëm me kërkesë të Ukrainës, për t'u konsultuar në Këshillin NATO-Rusi. Ne synojmë të angazhohemi me Rusinë në Këshillin NATO-Rusi.

Deklarata e mbledhjes së radhës të Këshillit të Atlantikut të Veriut sipas nenit 4 të Traktatit të Uashingtonit

Këshilli i Atlantikut të Veriut u mbledh pas kërkesës së Polonisë për të mbajtur konsultime brenda kuadrit të nenit 4 të Traktatit të Uashingtonit, i cili thotë se “palët do të konsultohen sa herë që sipas mendimit të tyre, kërcënohet integriteti territorial, pavarësia politike ose siguria e ndonjërit prej tyre”.

Pavarësisht thirrjeve të përsëritura nga komuniteti ndërkombëtar, Rusia vazhdon të shkelë sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës dhe të shkelë angazhimet e veta ndërkombëtare. Këto zhvillime, paraqesin pasoja serioze për sigurinë dhe stabilitetin e zonës euroatlantike. Aleatët qëndrojnë së bashku në frymën e solidaritetit të fortë në këtë krizë të rëndë. Ne do të ndjekim dhe do të intensifikojmë vlerësimin tonë rigoroz dhe të vazhdueshëm për të gjitha pasojat e kësaj krize për sigurinë e Aleancës, në bashkëpunim të ngushtë dhe konsultim. Ne vazhdojmë të mbështesim të gjitha përpjekjet konstruktive për një zgjidhje paqësore të krizës aktuale në përputhje me ligjin ndërkombëtar. Ne mirëpresim përpjekjet e vazhdueshme të ndërmarrura nga Kombet e Bashkuara, Bashkimin European, OSBE-në dhe Këshillin e Europës. Ne do të vazhdojmë të konsultohemi me Ukrainën brenda Komisionit NATO-Ukrainë.

Ne do të angazhohemi me Rusinë në Këshillin NATO-Rusi.

Alba Musaraj
Burimi: nato.it

NATO dhe Ambasadorët e BE-së bashkëbisedime të përbashkëta informale mbi Ukrainën

Këshilli i Atlantikut të Veriut (NAC) zhvilloi një takim të përbashkët jozyrtar me homologët nga Komiteti i Sigurisë dhe Politikave të Bashkimit European (PSC) në nivel ambasadorial më 5 mars, ku u diskutua rreth situatës në Ukrainë.

Zëvendëssekretari i Përgjithshëm i NATO-s, ambasadori Alexander Vershbow, bashkë-kryesoi takimin, i cili u mbajt në ndërtesën Justus Lipsius së Këshillit të BE-së. NATO dhe ambasadorët e BE-së diskutuan zhvillimet e fundit në Ukrainë dhe vlerësuan implikimet e tyre të sigurisë. Diskutimet treguan konvergencën e pikëpamjeve në të dy organizatat në ruajtjen e sovranitetit të Ukrainës dhe integritetit të saj territorial, nevojën e një dialogu ndërmjet Ukrainës e Rusisë si dhe hapat për gjetjen e një zgjidhjeje paqësore të krizës në respektimin e plotë të së drejtës ndërkombëtare të përcaktuar në angazhimet dy dhe shumëpalëshe. Ambasadorët patën një shkëmbim pikëpamjesh mbi dimensionet e ndryshme të krizës në Ukrainë dhe opionet për reagimin e bashkësisë ndërkombëtare. NATO dhe BE-ja bashkëpunojnë për çështje me interes të përbashkët dhe punojnë krah për krah në menaxhimin e krizave, zhvillimin e aftësive dhe konsultimet politike.

Rasmussen njofton Këshillin e Atlantikut të Veriut të përmbushë kërkesën e Polonisë lidhur me konsultimet e nenit 4

Këshilli i Atlantikut të Veriut, i cili përfshin ambasadorët e 28 anëtarëve të NATO-s, u mbledh më 4 mars, pas një kërkesë nga ana e Polonisë sipas nenit 4 të Traktatit Themelues të Uashingtonit. Sipas nenit 4 të këtij traktati, çdo aleat mund të kërkojë konsultime sa herë që sipas mendimit të tyre, kërcënohet integriteti i tyre territorial, pavarësia politike ose siguria. Zhvillimet brenda dhe jashtë Ukrainës, janë parë si kërcënim për vendet fqinje aleate dhe që kanë implikime të drejtpërdrejta dhe serioze për sigurinë dhe stabilitetin e zonës euroatlantike.



Zhvillohet ceremonia e emërimeve të komandantëve të Batalionit të Dytë të Këmbësisë dhe të Batalionit Komando

Emërimet e reja në FT, premtojnë vazhdimësi dhe ndryshime pozitive

Major Nexhbedin Basha

Më datë tre mars 2014, në sheshet e rreshtimit të Batalionit të Dytë të Këmbësisë dhe të Batalionit Komando, u zhvilluan ceremonitë e marrjes dhe e dorëzimit të detyrës të komandantëve të dy batalioneve. Në prezencën e efektivave ceremonitë nisën me komunikimin e urdhrave të ministrit të Mbrojtjes, për lirim dhe emërim në detyrë të dy komandantëve të batalioneve, si dhe leximin e Letrës së Falënderimit të komandantit të Forcave Tokësore, drejtuar dy komandantëve dorëzues të detyrës, kolonel Ardian Bali, Batalioni i Dytë të Këmbësisë dhe nënkolonel Arben Hoxha, Batalioni Komando. Në fjalën e tij përshëndetëse, komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, vlerësoi punën e komandantëve dorëzues, dhe ju uroi suksese të mëtejshme, komandantëve të sapo emëruar nënkolonel Edmond Sardi, në Batalionin e Dytë të Këmbësisë dhe nënkolonel Besim Bala, në Batalionin Komando, duke shprehur mbështetjen e tij të plotë dhe besimin, se do t'i çojnë më tej arritjet në këto batalione. Komandantët e sapo emëruar, falënderuan ministren e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor Jeronim Bazo, komandantin e Forcës Tokësore gjeneralmajor Zyber Dushku, për mundësinë e dhënë të drejtojnë këto reparte dhe e siguruan, komandantin e Forcave Tokësore, se do të punojnë me përkushtim në realizimin e të gjitha detyrave, që rrjedhin nga misioni si dhe detyrat e ngarkuara nga komanda dhe Shtabi i FT-së.

Nënkolonel Edmond Sardi, emërohet Komandant i Batalionit të Dytë të Këmbësisë

Më datë 3 mars 2014, në vijim të ceremonisë së ngritjes së flamurit u zhvillua ceremonia e ndërrimit të detyrës së komandantit të Batalionit të Dytë të Këmbësisë. Komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, vuri në dukje kontributin e dhënë nga Kolonel Ardian Bali, si komandant batalioni, të cilin e vlerësoi si ushtarak me cilësi të larta dhe një njeri qytetar në komunikim. Ai i uroi suksese në detyrën e komandantit të ekipit në mision MAT 5, në operacionin ISAF, Afganistan. Duke i uruar, mirëseardhjen, nënkolonel Edmond Sardi, Gjeneral Dushku, është shprehur se nënkolonel Sardi, është një ndër oficerët më të kompletuar të FA-së, i kualifikuar si brenda dhe jashtë vendit, oficer bashkëkohor dhe pjesëmarrës në disa stërvitje dhe misione ndërkombëtare. Batalioni i Dytë të Këmbësisë është përcaktuar repart prioritar në direktivën e MM ndaj dhe kërkohet përkushtim dhe profesionalizëm për të përmbushur objektivin. Viti 2014 është një vit i rëndësishëm për këtë batalion, pasi kompania e parë e këmbësisë e këtij batalioni është



caktuar si prioritar si pjesë e forcës së reagimit të NATO-s, (NRF). Puna me këtë kompani të mbetet objektivi Nr. 1, për komandantin dhe shtabin FT-së dhe batalionin. Motoja e gjithsecilit nga ne, të jetë përqendrim i energjive, përkushtim maksimal, disiplinë e vazhdueshme në të gjitha hallkat shtabin të FT, shtab të batalionit deri në kompani, togë skuadër, grup e individit për të arritur objektivat e marra. Nënkolonel Edmond Sardi, vjen në këtë detyrë pas një përvojë të mirë si komandant në nënrepartet e Forcave Tokësore dhe eksperience pune në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së, si specialist dhe oficer shtabi në Drejtorinë Operacioneve dhe Stërvitjes dhe në Drejtorinë e NATO-s dhe Politikave Strategjike në Ministrinë e Mbrojtjes. Komandanti i sapoemëruar e konsideron një përgjegjësi të madhe drejtimin e këtij batalioni dhe premtion se do të vijojë në traditën e mirë të krijuar dhe se përvojën e eksperiencën

e fituar gjatë karrierës ushtarake do ta vë në shërbim të rritjes së kapaciteteve operacionale të këtij batalioni. "Është e rëndësishme-u shpreh, nënkolonel Sardi- të ruhet vazhdimësia por është po kaq e rëndësishme të mirëpresim ndryshimin. Ndihejmë i privilegjuar të drejtoj këtë batalion. Misioni ynë, metoda jonë dhe synimi është shumë i qartë për mua. Unë do të vazhdoj të punoj duke u bazuar fort në përpjekjet dhe shërbimin e atyre që kanë pariparirë dhe ne do të krijojmë kushte të favorshme për ata që do të na ndjekin. Ky është një angazhim afat-gjatë". Në prononcimin e tij për gazetën "Ushtria", zëvendëskomandanti i FT-së, kolonel Dilaver Hoxha, u shpreh: "Është nder dhe kënaqësi njëkohësisht të marrësh pjesë në ceremoninë e ndërrimit të detyrës së komandantit të Batalionit të Dytë të Këmbësisë. Pas një pune mëse dy vjeçare, kolonel Ardian Bali arriti të ruajë dhe zhvillojë më tej nivelin

operacional të këtij batalioni, tashmë i renditur si një ndër më kryesorët për Forcat Tokësore. Vëmendja për konsolidimin e këtij reparti, ka qenë e vazhdueshme, edhe për faktin sepse përbën njësinë qendrore për zhvillimin e kapaciteteve në kuadrin e angazhimeve në Aleancën Euro-Atlantike".

Nënkolonel Besim Bala, emërohet komandant i Batalionit Komando

Pas përshëndetjes nga komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, me datë tre mars 2014, vijoi ceremonia e ndërrimit të komandantëve të Batalionit Komando. Nënkolonel Bardhyl Nuredinaj, shef i personelit të FT-së lexoi urdhrat, për lirim dhe emërim në detyrë të komandantit të Batalionit Komando. Më pas e mori fjalën komandanti dorëzues i detyrës, nënkolonel Arben Hoxha, i cili falënderoi efektivin për mbështetjen e dhënë në realizimin e detyrave, për profesionalizmin, gatishmërinë dhe përkushtimin

në përmbushje të misionit të batalionit. Komandanti i sapo emëruar nënkolonel Besim Bala pasi falënderoi autoritetet e larta civile dhe ushtarake, për besimin dhe vlerësimin e treguar, siguroi, që të gjitha njohuritë dhe eksperiencën e fituar ndër vite do ta vë në shërbim të progresit të batalionit. Komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, në fjalën përshëndetëse u shpreh se gjatë kësaj periudhe ne kemi punuar së bashku me një profesionalizëm të lartë në përmbushje të misionit. Njëkohësisht shpreh falënderimet dhe vlerësimet e tij për nënkolonel Arben Hoxha, i cili drejtoi batalionin me profesionalizëm dhe disiplinë të lartë në përmbushjen me sukses të objektivave të këtij reparti elitë të Forcave të Armatosura dhe njëkohësisht i uroi suksese të mëtejshme në karrierën ushtarake. Në të njëjtën kohë komandanti i Forcave Tokësore i uroi sukses në detyrën e re, nënkolonel Besim Bala, si komandant i Batalionit Komando dhe shprehur bindjen se me përvojën që ai mbart, përkushtimin ndaj detyrës, Batalioni i Komando do të lartësoi më tej performacën e tij në të gjithë spektrin e misionit. Nënkolonel Besim Bala, emërohet në detyrën e Komandantit të Batalionit Komando, pas një eksperience të gjatë në strukturat e FA-së si oficer për përgatitjen e kadrove të shtabit, oficer shtabi për planëzimin, specialist i menaxhimit të informacionit, komandant batalioni në Universitetin Ushtarak "Skënderbej", si shef i degës së zbulimit në Forcë Tokësore dhe pjesëmarrës në misione Bosnje Hercegovine dhe Irak. Përpjekjet e tij për rritjen e dijeve nëpërmjet arsimimit ushtarak, përfshi, Kursin e Sigurisë Europiane dhe Akademinë e drejtimit për FA në Gjermani, i kanë shërbyer për të qenë i suksesshëm në karrierën ushtarake.

Ushtarët e rinj marrin mesazhin e komandantit të Forcave Tokësore Kolonel Hoxha: rruga e nisur do të jetë e bukur, por jo e lehtë...

Më datë 3 mars 2014, kolonel Dilaver Hoxha, zëvendëskomandant i Forcave Tokësore zhvilloi një takim të veçantë, me ushtarët e sapo titulluar, Profesionalistë të Parë, të cilët po zhvillojnë Stërvitjen Individuale Bazë (SIB) në Shkollën e Trupës, Bunavi. Në emër të komandantit të Forcave Tokësore, ju uroi atyre suksese në rrugëtimin e nisur të karrierës së ushtarakut, duke ju kujtuar se tashmë jeta juaj ka marrë një kuptim tjetër, pasi jeni bërë pjesë e një ushtrie anëtare e NATO-s dhe si pjesëtarë të FA-së, rruga e nisur do të jetë e bukur, por jo e lehtë. Gjatë karrierës ju do të përballeni me sfidat të ndryshme që lidhen me detyrën që do të kryeni dhe do ju duhet shumë punë dhe përpjekje për t'u përshtatur me kërkesat, ligjet dhe rregullat që ka jeta ushtarake, për edukimin dhe formimin tuaj profesional dhe për të arritur standardet që kërkohen, me të cilat do të ballafaqoheni në çdo hap të jetës së karrierës tuaj.

"Ju, jeni ata ushtarë profesionistë të titulluar për të shërbyer në Forcat Tokësore. Vini në këtë forcë, pas një përzgjedhje të bërë nga Qendra e Personel Rekrutimit, në bazë të një testimi intelektual, fizik e shëndetësor. Kjo përzgjedhje ishte në radhë të parë rezultat i aftësive tuaja personale, që

tashmë do të merrni pjesë në SIB, e cila zhvillohet në Shkollën e Trupës. Për ju, ky është shansi më i mirë që ju ofrohet, pasi është një orientim i jetës suaj për të fokusuar të ardhmen. Forcat e Armatosura kanë nevojë për freskim brezash, kanë nevojë për energji të reja, për të përmbushur misionin e tyre kushtetues. Ky është starti, dhe vetëm me ambicie mund të arrini atë që ju



dëshironi dhe që presin Forcat e Armatosura. Nga ushtar profesionistë, ju keni mundësinë të bëheni nënofficerë të zotë pse jo dhe oficerë karriere. Por krahas vullnetit për ndjekjen e kurseve institucionale, detyrimisht me rezultate të larta, vëmendja duhet ti kushtoni si përgatitjes fizike ashtu dhe gjuhës së huaj apo më tepër arsimimit të lartë. Ju presim që në repartet e Forcave Tokësore të vini ushtarë me të vërtetë profesionistë dhe të denjë për t'i shërbyer kësaj force" - theksoi kolonel Hoxha. Ushtarët Profesionalistë të Parë, efektiv të Forcave Tokësore tashmë janë akomoduar dhe kanë filluar procesin mësimor, Stërvitjen Individuale Bazë (SIB) në Shkollën e Trupës, Bunavi. Megjithatë për 10 javë ata do të jenë në kurs, përsëri mbështetja e Komandës së Forcave Tokësore do jetë e vazhdueshme, ashtu si dhe monitorimi i rezultateve në të gjitha aspektet.

Rusia, u përball me koalicionin europian të mbështetur fuqishëm nga SHBA

Nga Zaim Kuçi

Për një gjerësi informacioni, analiza për konfliktin e radhës duhet të fillojë me pyetjen, Çfarë po ndodh me vendet e Eurozonës, të Europës Lindore dhe të Rajonit të Ballkanit, krizë reale ekonomike apo gjeopolitike e sforcuar ruse drejt tyre? Le ta shohim zgjidhjen e këtij konflikti tek kjo tendencë zhvillimi europian.

Situata e datës 1 mars. Zëdhënësi Dmitri Peskov u shpreh: “situata është në duar të presidentit Putin. Është presidenti Ai që merr vendimin. Për momentin nuk ka ndonjë vendimmarrje edhe pse ka lëvizje dhe mobilizim trupash, edhe pse shtabet luftarake kanë marrë postin e luftimit në zbatim të miratimit nga parlamenti rus “të urdhrorit” të ndërhyrjes luftarake në Ukrainë.

Situata e datës 5 mars. Një javë më pas presidenti rus thotë se “ne nuk luftojmë me popullin vëlla ukrainas”, duke shtuar se Rusia është gati të përdorë forcën nëse rusët në Ukrainën lindore dhe Krime do të jenë në rrezik. Rusia bëri edhe tërheqjen e parë duke deklaruar të mbyllur stërvitjen e trupave ruse në kufi me Ukrainën por nuk ka sqaruar asgjë mbi fatin e konfliktit. Çfarë ndodhi realisht në këtë fushatë të nisur luftarake? Fillimisht, le të vlerësojmë gjendjen e dy palëve në konflikt.

Bashkimi Europian: “Në kërkim të zgjidhjes së krizës...”

Në BE ndjehet, apo është krijuar një çarje në vetë shtetet e saj duke krijuar edhe blloqe: nga njëra anë shihen interesa të vendeve anglosaksone për shkëputje, nga ana tjetër kemi qëndresën franceze si ideatore dhe ajo gjermane si investitorja kryesore e BE, kurse vendet e tjera europiane që janë zhytur në krizën ekonomike janë për një forcim të saj, pra duket ndarja e shteteve elitë nga shtetet europiane në nevojë. Megjithatë këtë situatë jo të qartë europiane, vendet e saj unanimisht dhe forcërisht dënuan lëvizjen ruse drejt Ukrainës. BE edhe pse në nevojë ajo akordoi dhe 11 miliard euro për rimëkëmbjen e ekonomisë.

SHBA, kërcënuan se, në rast se Kremli do të vazhdojë të ndjekë kursin e tij aktual, atëherë mund të ketë masa ekonomike dhe diplomatike që do të çonin vendin në izolim. SHBA akuzuan Rusinë se po shkel ligjin ndërkombëtar dhe tha se Moskë “është në anën e gabuar të historisë”. Në Kiev, Sekretari i Shtetit Kerri tha: “Ne nuk (do) kemi alternativë tjetër, por ta izolojmë Rusinë politikisht, ekonomikisht dhe diplomatikisht”.

Rusia: “Mbron rusët e krimesë...”

Por, ajo që duhet vlerësuar në këtë konflikt të ri është fakti se, situatat e reja ekonomike kanë shtuar dëshirën e një gjeopolitike të re gjithnjë në ndryshim të saj. Rusia e ardhur nga një “fitore” e përgjakur në Siri, ka rritur ndjenjat për një zgjerim real të saj drejt vendeve ish aleate. Ajo kësaj radhe, iu drejtua Ukrainës. Disa situata favorizuese që shkojnë në interes të Rusisë: Nëse analizojmë krizat e ekonomike të kohëve të fundit, duket se vendet e vogla të ndodhura në hartën gjeografike europiane, të keq menaxhuar nga vet strukturat e tyre, kur bien në krizë kërkojnë daljen prej saj duke aktruar dhe luajtur kartën e gjeopolitikës së tyre. Analistët duhet të vlerësojnë përballë kësaj krize, zhvillimet e dukshme ekonomike të viteve të fundit të Rusisë, afrimi i sforcuar i saj me superfuqinë aziatike kineze e konfirmuar dhe me vizitën për herë të parë të presidentit të sapo zgjedhur kinez duke nënshkruar kontratën më të madhe në fushën e mbrojtjes (24 avionë luftarake SU-35, 4 nëndetëse të klasit “Lada”, avionë transporti IL-476 dhe IL-78, raketa Senit S-400 etj), kontratë e cila u analizua dhe si një sinjal force edhe për SHBA, se Moskë dhe Pekini duan të bashkojnë forcat e tyre për të bërë një kundërpeshë gjeopolitike ndaj saj, kanë ngjallur nostalgjitë e gjeopolitikës globale me prioritetin rajonin e

Konflikti ukrainas - një duel i hapur midis BE dhe Rusisë



Ballkanit dhe të Europës Lindore, prej këtej për të kapur tregjet në Lindjen e Mesme. Është koha kur gjeoekonomia vendos mbi zhvillimet e prishme në gjeopolitikën e shteteve. Vlerësohet se qëllimet strategjike ruse, për të gjetur territor në hapësirën e BE, realizohen duke lëvizur kujdesshëm, rast pas rasti me shtetet e vegjël që akoma nuk kanë arritur të instalojnë demokracinë dhe të zhvillojnë ekonominë në standard perëndimor. Zhvillimi i ekonomisë informale dhe të dobët në këto vende janë premisa për krizë, më tepër se kaq Rusia gjen terren për t'i stimuluar këto ekonomi në rënie. Në këto vende diplomacia ruse është aktive (sidomos ato në rajonin e Ballkanit, më pranë Bosnje-Hercegovina) duke iu afruar ndihmë ekonomike. Këto vende, për të mos u zhytur në kaos dhe për të përfutur imazh në vend (kredibilitet politik), lehtësisht shtrijnë duart për ndihmë drejt Rusisë, kjo shihet dhe si një presion të vet vendeve të hartës gjeografike europiane kundër BE-së. Hapja e portave për Rusinë nga këto shtete, vështirëson ekonominë dhe politikën europiane jo vetëm për mos prishjen e balancës ekonomike por në planin afatgjatë dhe për mos humbje territori në hapësirën e BE-së. Mbajtja prej kohësh peng e Serbisë nga rusët ka krijuar hallakatjen e rajonit tonë. Të detyruar nga situatat e krijuar në hapësirën e eurozonës, vendet europiane detyrohen dhe paguajnë borxhin e stimuluar dhe të keq menaxhuar të shteteve të vegjël. Pas Greqisë, rasti Qipriot ishte identik me atë të krizës Islandeze, kohë kur Europa po mbyllte dyert ata iu drejtuan Rusisë. Për të shmangur këtë orientim drejt Rusisë, FMN zgjidhi thesin e ndihmave për të nxjerrë nga kriza këtë vend. Këto janë shembuj të së kaluar së vonshme që tregojnë nisjen e një gjeostrategjike ruse ku është përfshirë dhe Ukraina. Rusia, për shumë arsye kësaj radhe iu “afra” Ukrainës për të cilën ajo e ka filluar kohë më parë nëpërmjet shërbimeve të fshehta që kanë mbajtur nën kontroll regjimin dhe situatën ukrainase, si një element bazë strategjik të saj. Por ajo që merret si shqetësim dhe si para kohe për Rusinë ishte vënia në gatishmëri të trupave të saj ushtarake (150 mijë - trupa speciale e helikopterë luftarakë, forcat të Këmbësorisë Detare dhe ato të Mbrojtjes Bregdetare e të tjera). Në fokusin e një analisti ushtarak, sjellja ushtarake ruse, që kupton përgatitjen e fazave të zhvillimit të

operacionit nga gjeneralët dhe admiralët, dalja e forcave të luftimit në rajonet e veprimeve luftarake, miratimi njëzëri në parlament i “pushimit”, vlerësohet jo vetëm si një presion i hapur për të përfutur territore nga shteti i Ukrainës por dhe një sinjal i qartë për mundësi ndërhyrje ushtarake. Për të justifikuar këtë prezencë, Rusia shfrytëzoi Bazën Ushtarake në Portin e Sevastopolit, me synim ndarjen e Krimesë nga Ukraina duke formuluar të drejtën për të mbrojtur bashkëkombësit e saj. Për një shpërndarje vëmendje, ushtarakët rusë nisën një anije luftarake zbulimi drejt Kubës me mision “vizitë” miqësore dypalëshe. Kjo vizitë ushtarake në këtë vend të largët, nga shtypi është vlerësuar si një memorie paralajmëruese të viteve 1962 hrushoviane që stimuloi krizën raketore kubaniste me tendencë për të krijuar konfliktin bërthamor të asaj kohe. Lind pyetja, cili ishte mesazhi rus? A mos vallë Rusia ndjehet e forte ekonomikisht dhe ushtarakisht dhe kërkon të rimarrë pozicionin superfuqi globale? A mos vallë ky globalizëm i përshpejtuar dhe i pakontrolluar po sjell nevojën e një situatë paralufte? A mos vallë përsëri po maten forcat e superfuqive botërore? Janë pyetje që në këtë fillim shekulli kanë mbetur pa përgjigje edhe pse bota mbarë u mobilizua një pjesë për të bërë luftë dhe tjetra për ndalimin e saj. Nëse Rusia vërtet synoi të shkonte në këtë aventurë të kohës dhe sipas saj i llogarit forcat që të përballonte këtë sfidë të re në gjeopolitikën të menduar globaliste të sajuar prej saj, atëherë logjikisht ajo mund të shkonte drejt një strategjie për t'u sakrifikuar për të pushtuar Ukrainën. Nga ana tjetër, SHBA, BE dhe NATO e mirë vlerësuan situatën, këtë radhë në kohë, ndoshta dhe të “djegur” nga aventurat diktatoriale të liderëve të papërgjegjshëm, siç dhe po ndodh shpesh, duke marrë edhe rastin banal të ndërhyrjes të Rusisë pak vite më parë në Gjeorgji.

Po përse Ukraina ishte e privileguara e radhës për Rusinë?

Së pari, gjeografikisht Ukraina vlerësohet një pozicion i favorshëm dhe të menduar, të fituar nga rusët. “Molla e artë” e rusëve është Krimea (dymilion banorë që flasin rusisht), e cila ndodhet në pozicionin më strategjik të rajonit ku historikisht dy portet e saj Sevastopoli dhe Odesa kanë qenë skalionime bazë për arrijtjen e kontrollit të Detit të Zi duke afruar

dhe një tjetër mundësi hapësinore më të largët se ky det, ai i Detit Mesdhe, si dhe lehtëson daljen në Detin e Veriut dhe atë Balltik të Rusisë. Së dyti, Ukraina duke qenë një kombësi (lindore e juglindore) pothuajse ruse, me kohë ka favorizuar zhvillime të përbashkëta në të gjitha fushat, pra nostalgjia ruse është prezent. Në fakt ndodhi e kundërta. Rusia duhej të merrte në konsideratë në këtë konflikt edhe faktin që, apo të zgjidhte dilemën nëse ushtarët e tyre do të qëllonin mbi ata ukrainas dhe anasjelltas. Gjendja morale e luftëtarit është një element i rëndësishëm për t'u vlerësuar në fushën e luftimit. Së treti, pasuritë bujqësore dhe ato minerale vlerësohen të konsiderueshme, që për Rusinë janë vlerësime strategjike që rrinë zgjuar në planet aventureske të saj. Fillimi i veprimeve luftarake, gjithmonë kërkon një akt legjitimi për të hapur një luftë ndërshtetërore. Kjo ishte fundamentale për Rusinë, e cila duhej të gjente argumente bindëse edhe pse kemi përvojë të papranueshme me këtë shtet, si rasti me Gjergjinë apo vendosja shpesh e “vetos” kundër OKB, NATO-s, BE, SHBA dhe thyerja e shumë marrëveshjeve diplomatike, ekonomike dhe ushtarake në vatrë e nxehta të globit. E vetmja arsye për rusët do të ishte e ashtuquajtura e drejta e mbrojtjes të “bashkëkombësit” të tyre, rusët e Ukrainës. Propaganda ruse ka qenë me akuzë të forta kundër perëndimit që sipas tyre ka mbështetur grushtin e shtetit. Rusët janë të favorizuar dhe nga deklaratat dhe kërkesa për ndihmë nga ish presidenti ukrainas për të mbrojtur qytetarët e saj. Protestuesit dolën në sheshin pavarësia kur presidenti i tyre nuk nënshkroi marrëveshjen me BE. Viktimat e Kievit ishin qytetarë ukrainas të cilët kërkuar të drejtën legjitime për të qenë pjesë e të drejtës gjeografike - qytetarë të Europës. Angazhimi i BE-së ndaj Ukrainës nuk mund të personalizohet “interesa” dhe se kërkon zgjidhjen përmes forcës siç dhe pretendohet nga rusët. Sigurisht edhe NATO, si një organizëm gjithëshqetesh nuk mund të ndërtojë interesa personale strategjike të një shteti të vetëm elitë të saj. Këto organizma kanë si armë fillimisht dialogun diplomatik të shoqëruar me presione ekonomike siç dhe po ndodh me këtë vend. Ushtarakisht, potencialet ruse janë në rritje dhe të mëdha, të përfutur dhe nga fakti se vendet më të zhvilluara të botës janë në zvogëlim të buxhetit ushtarak. Nga kjo pikëpamje thjesht ushtarake e raportit të forcave, lufta mund të ishte e suksesshme edhe pse pritej një katastrofë njerëzore. Në kohën e sotme çështja e luftës, merr gjerësi post saj. Për Europën dhe më gjerë problemet më të mëdha do të vinin pas lufte. Tashmë nuk supozohet analiza për fitoren thjesht ushtarake të rusëve ndaj Ukrainës. Ajo që vlerësohet sot është: cila do të jetë strategjia e daljes nga lufta? Çfarë do të bëhet pas saj? Europeanët, më tepër Rusët, duhet të merrnin në konsideratë popullsinë 45 milionëshe ukrainase. Shembuj e post luftës në Irak e Afganistan tregojnë për një tjetër “luftë” ajo e rivendosjes dhe ruajtjes së paqes kur lufta ka mbaruar. Nëse i referohemi sjelljes së luftës, pas këtij kërcënimi të Rusisë për luftë, nga të gjithë organizmat e sigurisë botërore (OSBE, KS, NATO, OKB) u dënua dhe aspak nuk ishte një çështje e drejtë, apo një zgjerim të konfliktit për përfshirjen rikoshet të mundshëm të Rusisë, por ishin dhe mbeten përpjekje strategjike të Rusisë për të kthyer mundësisht Perandorinë e Madhe Ruse (Le Grand Tsar). Gjeo-

strategjia ruse, me ardhjen në pushtet të Putinit, riformuloi konceptin e orientimit, ajo që konsiderohet si koncepti euroaziatik duke e vlerësuar shpërbërjen e Ish Bashkimit Sovjetik si “katastrofë më të madhe gjeopolitike të shekullit të 20-të”. Në interes të kësaj strategjie, ai ka nisur politikën ruse për të krijuar një kundërpeshë të Bashkimit Europian, të ashtuquajturin “Bashkim Eurazian”, i cili do të gruponte: Ukrainën, Bjellorusinë dhe Kazakistanin me Rusinë, domethënë bazën ekonomike, industriale, ushtarake të Ish Bashkimit Sovjetik. Analistët rus prej kohësh kanë sjellë si alternativë zhvillimi doktrinën -Multipolaritet- si një forcë kundër asaj amerikane -Njësipolariteti. Rusia është një fuqi tokësore euroaziatike, edhe Kina sipas saj është fuqi kontinentale tokësore, të cilën e fton si aleat, në përplasje me Shtetet e Bashkuara, ky është një koncept strategjik rus. Kërkesa të tilla janë absurde, e gjithë kjo do të jetë një katastrofë për Rusinë, si dikur me Luftën e Ftohtë, ajo nuk i ka potenciale ekonomike për një forcë ushtarake globale, që të përballojë vendet e zhvilluara të BE-së dhe SHBA-së. Në se vlerësojmë situatat, duket se po rihapet kapitulli i Luftës së Ftohtë, që mund të çojë edhe me ndryshime kufijsh. Gjithsesi, ndryshime terrore mund të ketë, por këto ndryshime nuk do të vijnë nga përdorimi i forcës, bota është e tejnogopur me armatime, nga ku në se fillon konflikti luftarak, nuk do të ketë fitues por vetëm humbës, më e pranueshmja do të jetë loja e kompromisit në gjithëpërfshirja formatesh qofshin këto diplomatike, politike dhe ekonomike. Në këtë forbull pasigurie apo euforie, ndoshta Rusia nuk i ka bërë mirë llogaritë me kërcënimin e forte të kartës së “Gazit” (edhe pse Gjermania është në vartësi të këtij projekti) që, nëpërmjet kësaj strategjie mund të mbajë të hapur Luftën e Ftohtë. Politikisht Rusia mban në presion vendet e angazhuara dhe luan bindshëm me këtë “kartë” por, ekonomikisht ajo është në nevojë shitjeje për të fituar nga rezervat e kësaj ekonomie strategjike. Situata në Ukrainë ishte dhe mbetet një lojë ruse, një test për BE-në e cila është në dilemat e saj por dhe për SHBA. Vlerësoj se, e gjithë kjo erdhi nga momenti i duhur rus, si triumfator politik në Siri, Iran dhe pse jo dominim të saj në Lindjen e Mesme. Gjithsesi kjo lëvizje ruse ndoshta do t'i shërbejë apo do të jetë një ëndërr e saj për shkëputjen e Krimesë drejt Federatës Ruse, kjo direkt apo me referendum, apo kompromis i heshtur, lufta them se nuk ka mbaruar ajo do të vazhdojë të jetë në “bazën e nisjes” në se forca goditëse e SHBA dhe BE nuk do të jetë më e fortë se ajo e sulmuesit. Nga ana tjetër, kjo situatë e kaluar duhet të përshpejtojë iniciativat europiane për të hapur dyert e integrimit të Ukrainës në BE, më e kërkuar në urgjencë mbetet integrimi sa më parë në NATO. Vendimi tashmë i deklaruar i Rusisë për pushtimin e Krimesë, pjesë e sovranitetit të Shtetit të Ukrainës, është një kthim tepër i gabuar i këtij shteti në të kaluarën, që për botën dikur ishte mbrojtjes i lirive, komb vital që në luftën e Dytë Botërore përgjaku popullin e vet në hapësirat europiane në luftën kundër nazifashizmit, sot fatkeqësisht ajo po ringjall konflikte luftarake. Rusia e njohur si kombi i letërsisë moderne botërore, i artit që udhëhoqi epokat po rikthehet në të padëshirueshmen në kulturën e hegemonisë së forcës. Ajo po e bën këtë në një kohë kur po ecet në një globalizëm human e njerëzor, reagimi kundër saj duhet të jetë global, nesër do të jetë vonë.

DITA NDËRKOMBËTARE E GRAVE

Perspektiva gjinore dhe Forcat e Armatosura në këndvështrimin e NATO-s

Flet Mari Skaare, Përfaqësuesja Speciale e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s

Kolonele(r) Suzana Jahollari

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Grave, Përfaqësuesja Speciale e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, për Gratë, Paqen e Sigurinë, zj. Mari Skaare, iu përgjigj pyetjeve për implementimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit UNSCR 1325 të OKB-së, lidhur me gratë, paqen e sigurinë në Aleancë dhe në Misionet e saj, specifiku në Afganistan. Zj. Mari Skaare adreson rolin e femrave ushtarake, prezencën e femrave në vendimmarrje dhe angazhimin afatgjatë të NATO-s për çështjet gjinore në Afganistan. Atlantic – community.org është e para politikë e jashtme on-line think-tank që fokusohet në çështjet që ndikojnë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Atlantic-community.org mori tridhjetë pyetje nga përfaqësues të dhjetë vendeve të ndryshme të botës. Përfaqësuesja Speciale Skaare zgjodhi pesë pyetje që trajtonin më gjerësisht çështjen dhe paraqiti përgjigjet e saj në Ditën Ndërkombëtare të Grave dhe paraqiti një video konferencë për çdo pyetje përgjigje; për dy pyetjet e fundit që kishin ngjashmëri paraqiti një video të vetme. Pyetjet dhe përgjigjet ishin si vijon:

MSc Natasha L. Lamoreux, nga Qendra për çështjet globale, Universiteti i New York-ut, konsulente për të drejtat e njeriut dhe çështjet gjinore në SHBA bën këtë pyetje: “Femrat që shërbejnë në forcat e NATO-s janë pjesë e strategjisë së NATO-s për implementimin e UNSCR 1325 në operacione. Për shembull këshilltarët gjinorë dhe femrat ushtarake kanë qenë të rëndësishme në përmbushjen e misionit në Afganistan. Pyetja është çfarë plani ka NATO për të rritur numrin e femrave në këtë shërbim me qëllim që të arrihen kërkesat për këshilltarët gjinorë dhe femrat ushtarake. A është diçka kritike kjo në se në NATO do të implementohet Rezoluta 1325?” Zj. Mari Skaare i përgjigjet: Përfshirja e femrave në Forcat e Armatosura dhe të paturit e këshilltarëve gjinore në operacione është shumë e rëndësishme. Politika e NATO-s për gratë, paqen dhe sigurinë është shumë



më e gjerë se kaq. Politika bazë për gratë, paqen e sigurinë është realizuar nëpërmjet Rezolutës 1325 nga OKB dhe katër Rezoluta të tjera të adaptuara po nga Këshilli i Sigurimit. Qeveritë kanë përgjegjësinë primare implementimin e këtyre rezolutave. Organizata e Kombeve të Bashkuara është në krye të Komunitetit Ndërkombëtar dhe NATO është duke bërë pjesën e saj. Politika e NATO-s për UNSCR 1325 “Për gratë, paqen e sigurinë” mbulon si operacionet ashtu dhe sigurinë kolektive. “Që të jemi në gjendje të kuptojmë kompleksitetin dhe dinamikën e konfliktit dhe se si ndikon në mënyrë të ndryshme te burrat dhe gratë, nevojitet kompetencë në çështjet gjinore. Është marrë eksperiencia dhe kontributi me vlerë nga këshilltarët gjinorë. Ajo që duhet të nënvizoj është e rëndësishme që së bashku burrat dhe gratë janë trajnuar të jenë në gjendje për të realizuar këtë funksion. Një strukturë kyç në NATO për këtë është Komanda e Transformimit e Aleancës (ACT). Qendra Nordike për çështjet gjinore në operacionet ushtarake në Suedi ka tashmë një shef departamenti për çështjet gjinore që lidhet me trajnimin. Ky është një hap i rëndësishëm. Megjithatë deri tani këshilltarët gjinorë në operacionet që organizon NATO vijnë nga vet shtetet anëtare. Tani, organizata e Atlantikut, NATO është duke mbështetur pjesëmarrjen e femrave në nivele

të larta në vendim marrje dhe për një rol më të fortë të tyre në parandalimin e konflikteve, menaxhimin dhe zgjidhjen e tyre. Gratë, si në të gjithë fushat e tjera, duhen të përfshihen dhe në këto operacione dhe në të gjitha nivelet. Kështu pyetjes se çfarë mund të bëjë NATO për të mbështetur rritjen e numrit të femrave në Forcat e Armatosura të shteteve, i përgjigjemi se NATO nuk vepron direkt në planizimin e mbrojtjes së shteteve. Ajo, NATO, inkurajon dhe informacionit dhe të praktikave më të mira të rekrutimit dhe të politikave për ruajtjen e kontingjenteve të femrave në Forcat e Armatosura. Është e rëndësishme që planizimi i mbrojtjes i adresohet së bashku nevojës për të përfshirë femrat dhe kompetencat për çështjet gjinore si kapacitete të nevojshme për mbrojtjen.”

Kolonele(r) Suzana Jahollari, lektore në Akademinë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i bën pyetjen: “Rëndësia e rritjes së numrit të femrave në Forcat e Armatosura është njëra anë e diskutimit për çështjen gjinore në ushtri. Por një aspekt shumë i rëndësishëm është ndryshimi i mentalitetit tek personeli ushtarak, së bashku femra e meshkuj, nëpërmjet rolit të liderit dhe të vendimmarrësit. Si mund të arrihet kjo?” Zj. Mari Skaare i përgjigjet: “Bota ushtarake

tradicionalisht ka qenë e dominuar nga meshkujt, megjithëse hendeku gjinor duket se ngadalë po ngushtohet. Ne duhet të përmirësojmë sistemin tonë të raportimit brenda NATO-s, por shifrat tregojnë se në disa ushtri të vendeve të NATO-s përqindja e femrave është njëzetë përqind ndërsa në disa të tjera është në përqindje të ulët. Megjithatë nuk është çështje thjesht shifrash. Mentaliteti i njerëzve është themelor për të integruar me sukses një perspektivë gjinore në veprimtarinë e përditshme në strukturat ushtarake dhe në strukturat civile. Rritja e ndërgjegjes është sfidë, por dhe hap themelor për të arritur rezultate. Dhe që të arrihet kjo është e rëndësishme trajnimi e

Sekretari i Përgjithshëm I NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, gjenerali Knud Bartels (Drejtues i Komitetit Ushtarak të NATO-s), gjeneral Jean-Paul Palomeros (Komandanti i Komandës së Aleancës për Transformim), Mari Skaare (Përfaqësuesja e Veçantë e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s për Gratë, Paqen dhe Sigurinë) dhe disa ministra të NATO-s



arsimimi i liderit politik. Dhe NATO po tregon liderit politik. Në Samitin e Cikago-s dhe në Lisbon, Kryetarët e shteteve dhe qeverive bënë një deklaratë të fortë politike dhe shprehën angazhim në kontributin e NATO-s për gratë, paqen e sigurinë dhe axhendën e sigurisë. Angazhimi i Sekretarit të Përgjithshëm të Aleancës është i madh dhe kjo është e rëndësishme. Aleanca nuk ka direkt autoritet për masat trajnuese dhe zhvillimet në nivel kombëtar, por kërkon që personeli që shkon në mision dhe merr pjesë në operacione të NATO-s, të jenë të trajnuar, të arsimuar dhe të kenë sjellje sipas standarteve. Ndryshimi i mentalitetit është një proces



1

PYETJA

↳ **MSc Natasha L. Lamoreux,** nga Qendra për çështjet globale, Universiteti i New York-ut

2

PYETJA

↳ **Kolonele(r) Suzana Jahollari,** lektore në Akademinë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë

3


PYETJA

↳ **Courterey Burns, student** në Shkencat Politike, Universiteti i Missurit, SHBA

4

PYETJA

↳ **Thomas Jakhelin,** bankier gjerman



Përfaqësuesja
Speciale e Sekretarit të
Përgjithshëm të NATO-s,
për Gratë, Paqen e Sigurinë,
zj. Mari Skaare, iu përgjigj
pyetjeve për implementimin
e Rezolutës së Këshillit të
Sigurimit UNSCR 1325
të OKB-së

i gjatë, por sinjale pozitive duken. Kjo na bën që të ketë optimizëm në këtë drejtim, veçanërisht për të ardhmen. Sot ka modele rol meshkujsh dhe si avokat të të drejtave të barabarta dhe mundësive për femrat e meshkujt gjithashtu dhe në sektorin e sigurisë. Femrat dhe meshkujt janë aleat në këtë betejë.”

Courterey Burns, student në Shkencat Politike, Universiteti i Missurit, SHBA: “Inkorporimi i femrave në parandalimin e konflikteve, menaxhimin dhe zgjidhjen e tyre a jep në mënyrë automatike rezultatin që gratë janë më paqësore se meshkujt? Në se po, a është kjo një gjë e mirë që kemi?” Zj. Mari Skaare përgjigjet:

“Ka shkolla të ndryshme mendimi për këtë. Unë tërheq vëmendjen kundër stereotipit se femrat janë më paqësore se meshkujt. Nuk mendoj se është e vërtetë. Unë besoj dhe që mund të bëhet argument i rrezikshëm që minon të drejtat e barabarta, mundësitë e barabarta dhe përgjegjësitë për femrat e meshkujt. Kur shohim femrat të marrin një perspektivë të gjerë, përshembull në sektorin e sigurisë njerëzore, unë besoj se është eksperiencia dhe roli social që e formon këtë më tepër se sa ai biologjik. Në mënyrë që të jemi më të përgatitur për të arritur sfidat e sigurisë së shekullit 21-të ne duhet të përdorim talentet, eksperiencat, aftësitë që sjellin gratë. Forcat e Armatosura

dhe institucionet e sigurisë duhet të reflektojnë përbërjen e popullsisë sonë. Eksperiencat e grave nga konflikti shpesh janë të ndryshme nga eksperiencat e burrave. Kur bëhen rezolutat e konflikteve duhet të përshkruhen këto eksperiencia dhe zëra. Gratë nuk janë vetëm viktime pasive, ato janë aktive dhe të forta. Ato përfaqësojnë më shumë se gjysmën e popullsisë të të gjithë shoqërisë. Domosdoshmëria e të pasurit më shumë femra në sektorin e sigurisë dhe në menaxhimin e zgjidhjen e konflikteve nuk është e përcaktuar nga natyra më paqësore e femrave se e meshkujve, në se femrat e kanë atë, por nga legjitimiteti dhe nevoja për të identifikuar siguri për të gjithë. Ajo nuk mund të arrihet pa përfshirë femrat. Nuk është thjesht çfarë përfitojnë femrat, por çfarë përfiton tërë shoqëria, femrat dhe meshkujt. Kur vjen çështja te ajo se çfarë komuniteti ndërkombëtar mund të bëjë për të siguruar pjesëmarrjen e femrave në rezolutat e konflikteve, atëherë përgjigja është se janë shtatë pikat e planit të veprimtimit të Kombeve të Bashkuara.”

Thomas Jakhelin, bankier gjerman: “Si planifikon NATO të sigurojë gratë e vajzat afgane që sot marrin pjesë në aktivitete të ndaluar nga Talebanët, pasi të tërhiqen forcat e NATO-s në vitin 2014?” Zj. Mari Skaare i përgjigjet: “NATO dhe ISAF, partnerët e Afganistanit janë

angazhuar në promovimin e rolit të rëndësishëm që femrat mund të luajnë në parandalimin, menaxhimin, zgjidhjen e konflikteve. Ne kemi mësuar që të pasurit këshilltar gjinor në fushë të cilët janë femra e meshkuj, kanë forcuar aftësitë e komandantëve të planizojnë dhe zbatojnë operacionet. Pjesëmarrja e femrave ushtarake në operacione në Afganistan ka bërë të jemi më në gjendje të lidhemi me gratë lokale atje. Përfshirja e perspektivës gjinore në operacione në Afganistan thjesht ka ndihmuar komandantët të marrin vendime më të mira. Përmes moderimit dhe aktiviteteve trajnuese, NATO mbështet objektivat e Afganistanit për të rekrutuar dhe mbajtur femrat në Forcat e Sigurisë. Afgani-stani ka femra në Forcën e Sigurisë, në Forcat e Armatosura dhe në Polici. Është udhëhequr rruga duke thyer tavanin e qelqit. Shifrat janë të pakta, por ato kanë tendencë e po rriten dhe autoritetet afgane punojnë për institucionalizimin e mekanizmave që mbrojnë e ndihmojnë femrat në punën e tyre.” Eksperiencia në Afganistan tregon atje se gratë janë në gjendje dhe duan të marrin pjesë në vendim marrje. Ato marrin pjesë në zgjedhje dhe janë zgjedhur. Ato krijojnë NGO, shoqata jo qeveritare dhe kanë një zë të rëndësishëm. Ato kanë kapacitetet dhe vendosmërinë për të vendosur për të ardhmen e tyre. Në Parlament dhe në Shoqërinë civile ka mjaft femra të forta dhe meshkuj që punojnë fort për të siguruar një të ardhme të mirë për të gjithë gratë në të gjithë vendin. Afganistani po punon për Planin Kombëtar të Veprimtimit dhe kjo punë do sigurojë të drejtat e grave. Në vitin 2014 misioni i NATO-s përfundon në Afganistan, por do vazhdojë angazhimin me disa partnerë për trajnim, këshillim, asistencë të Forcës së Sigurisë pas 2014. NATO punon brenda kontekstit të komunitetit ndërkombëtar dhe punon për promovimin e gruas, paqes dhe axhendës së sigurisë. NATO nuk

udhëheq në këtë çështje, por mbi bazën e shembujve, demonstroi lidership përmes aktiviteteve, arsimit dhe trajnimit dhe rëndësisë që i jep rolit të grave dhe në drejtim të zbatimit në praktikë të UNSCR 1325. Dhënia e këtij sesi pyetje – përgjigje në ditën ndërkombëtare të grave i shërben bërjes apel të të mos lodhurit kurrë për promovimin e mundësive e shanseve të barabarta si për meshkujt e femrat. Kjo i shërben dhënies dimension europian pjesëmarrjes së femrave në Forcat e Armatosura. Në këtë Ditë Ndërkombëtare të Grave edhe Shoqata jonë, “Gratë në Forcat e Armatosura të RSH”, në përvjetorin e tretë të aktivitetit të saj, modestisht përpigjet për realizimin e objektivit për thellimin e të kuptuarit dhe të lidhjes ndërmjet perspektivës gjinore në forcën e armatosur në nivel kombëtar dhe operacioneve ndërkombëtare. Mesazhi që japim sot për të gjitha gratë, vajzat, ushtarake dhe civile në Forcat e Armatosura, është kurrë të mos lodhemi së mësuarit e punuarit, kurrë të mos lodhemi duke dhënë modelin e femrës së arsimuar e me nivel të lartë profesional, me integritet e krenare që punojmë në këtë sektor të vështirë e me dominancë mashkullore, në çdo pozicion pune në sektorë mbështetës apo në operacione. Të inspirohemi nga deklarimi i Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, z. Anders Fogh Rasmussen, në Konferencën Vjetore të Komitetit të Perspektivës Gjinore në Shtabin e NATO-s, Maj 2013: “Ne duhet jo vetëm të integrojmë çështjet gjinore në planizimin e operacioneve tona, por ne duhet të punojmë aktivisht të zhvillojmë mundësitë tona në këtë fushë. Fuqizimi i mëtejshëm dhe mbrojtja më efektive e grave ndaj rreziqeve specifike që ato përballen në konfliktet e armatosura është në përfitim jo vetëm të grave, por të të gjithë ne. Është një komponent i rëndësishëm për të siguruar përballjen me sfidat e shekullit të 21-të”.



DY FJALË PËR LEXUESIN

Dy numra më parë gazeta jonë "Ushtria" botonte një shkrim të Zaïm Kuçi (kol (r)), me titull "Për një qasje kombëtare në zhvillimin e Politikës së re të Mbrojtjes në fushën e Arsimimit të FA". Për mendimin tim shkrimi ishte mjaft interesant dhe reflektonte ide mjaft racionale në objekt arsimin profesional ushtarak. I rëndësishëm është edhe fakti që ky shkrim vjen në të njëjtën kohë me hedhjen e Direktivës së Ministres së Mbrojtjes për vitin 2014, ku opinioni i autorit vjen origjinal për një numër çështjesh që shtrohen në Direktivë. Personalisht falënderoj autorin dhe stafin e gazetës për hapjen e një rubrike të tillë. Është në vazhden e rubrikës "Academicus", që tentoi të hapte edhe në vitin 2011, por u përveç shkrimit të dr. Simon Gega, nuk patëm shansin të shihnim opinione të tjera për çështjen në fjalë. Pikërisht, në këtë vazhdë është edhe shkrimi që po nis pranë gazetës sonë. Që në hyrje theksoj se pozicionimet e vlerësime të ndryshme gjatë këtij shkrimi janë personale, bazuar në njohuri dhe bindje që kam krijuar nga studimi, analiza dhe eksperiencia personale. Shkrimi që vijon është pjesë e një shkrimi më të gjerë përgatitur për forum akademik. Sjellja në këtë numër po vjen në format të reduktuar dhe me natyrën e vete gazetës. Ai vazhdon me pjesën e dytë: Evolimi 100-vjeçar i modelit të APU në vendin tonë; dhe në pjesën e tretë: "10 modelet më të mira në botë për sistemin e Arsimimit profesional Ushtarak. Mirëpresim komentet e lexuesve.

Kolonel Prof. Dr. Kristaq Xharo

Qeveria do të mundësojë që Forcat e Armatosura të ngrihen në një nivel më të lartë profesionalizmi dhe gatishmërie, për të mundur të marrin përsipër një gamë më të gjerë detyrimesh, në shërbim të qytetarëve të këtij vendi, si në raste emergjencash apo fatkeqësish, ashtu dhe në shërbime të tjera të nevojshme për të mirën publike..." (Edi Rama, 11.11.2013, në Garnizonin "Skënderbej")

Nisje

Në objektin për të arritur një krahasim e analogji midis arsimimit profesional ushtarak në vendin tonë me eksperiencën më të mirë botërore të arsimimit profesional ushtarak po përpiqem të sjell në vëmendje tre fakte, të paraqitura on-line në media kohët e fundit:

Së pari Website i njohur OnlineCollege.org, ka realizuar listimin e "Top-10" për akademi / universitete ushtarake, por edhe kolegjeve/ akademive të mbrojtjes. Nga rreth 40 institucione që përmenden në këtë renditje, në tre listime nga agjenci të ndryshme, ato që qëndrojnë në vendet e para të renditjes janë akademitë amerikane, britanike, franceze, gjermane, italiane. Por, është interesant fakti që në "Top -10" e institucioneve më të mira përmenden edhe akademi ushtarake nga rajoni ynë. Institucionet tona mungojnë në këtë listë me mbi 40 të tilla.

Së dyti në një listim në "Memorandum of Chairman Of Joint Chiefs of Staff - CM-1471-11" të SHBA, njihen përmbi 111 institucione të arsimimit profesional ushtarak (APU) të cilat përfaqësojnë institucione për nivelet bazë apo nivelet e mesme të karrierës nga e gjithë bota me të cilat kryhen ekuivalente dhe transferime kreditesh. Por, përsëri asnjë nga institucionet tona nuk figurojnë në listën prej 111 institucione.



Foto arkiv

Në këtë listë ndodhen akademi nga një numër vendesh të rajonit, si edhe nga gjithë kontinentet: Europa, Australia, Afrika, Azia e Amerika Latine. Një numër akademish që përmenden në këtë listë figurojnë edhe në dy lista, që ne kemi hartuar për ekuivalentim me institucionet e huaja në urdhrin e MM në vitet 2008 dhe 2012. Interesant është gjithashtu fakti se deri në vitin 2011, Akademia e Drejtimit në Gjermani njihet si ekuivalente nivelet e studimit që realizoheshin në Akademinë tonë të Mbrojtjes.

Së treti, para pak ditësh një numër mediesh vizive dhe elektronike paraqitnin një renditje mbarë botërore të institucioneve të arsimit të lartë (universitete) gjithsej rreth 20 745. Universitetet tona, renditeshin në intervalin (në 90% të tyre) pas numrit 20 634. Edhe renditjet e mëparshme vështirë se kanë qenë më optimiste. Prej këtij këndvështrimi, një renditje e tillë e arsimit tonë universitar, vështirë se

mund të shërbejë si bazë solide për t'ju referuar për një të ardhme të afërt për konturimin e edhe të sistemit të arsimit profesional ushtarak.

Citimet e mësipërme mund të shërbejnë si bazë për të risjell për debat e analizë e për problemin e Arsimimit Profesional Ushtarak. Duket se jemi në kohë pasi ky moment lidhet edhe me procesin që ka hapur qeveria për një rivlerësim e ri-konceptim të thellë të gjithë sistemit të arsimit në RSH.

Përse një debat për modelin ...

"...Fitorja dhe suksesi ju buzëqesh atyre që kanë vizion të parashikojnë ndryshimet në natyrën dhe dinamikën e konflikteve, por gjithmonë e më pak atyre që presin të adaptojnë veten pasi ndryshimet ndodhin ..." Alvin Toffler (Professional Military Education in 2020)

Duke dashur të prekë konceptin e modelit qëllimi është për të siguruar një pozicion zgjedhje për të analizuar disa nga zhvillimet e mëparshme, por

edhe që mund të kenë impakte kohët dhe sfidat e ardhme. Janë disa modele ku është tentuar të synoj arsimit ynë ushtarak gjatë këtyre 100 viteve. Ndryshimi i modeleve, jo rrallë është parë me synime afat-shkurtëra. Pothuajse mungojnë analizat për ndërprerjen, shpëputjen nga një model arsimimi dhe ka pasur plot eufori për kalimin në një model tjetër. Është identike si ata që në pamundësi për të mësuar një gjuhë të huaj, e gjejnë "argumentin" të ndryshojnë metodikat. Në qoftë se një model nuk ka qenë i suksesshëm në kushtet tona, asnjëherë nuk janë analizuar shkaqet apo shkaktarët, ndërprerjet apo ndryshimet. Reforma e thellë në procesin e arsimit profesional ushtarak do të mundësojë që mbi formatin e traditës dhe eksperiencës të konceptojmë një proces sa më ambicioz arsimimi. Frytet e kësaj reforme mund të ravijëzohen si vizion 2020 -2025. Mendoj se për sa më sipër mund të na shërbente për nisje të debatit jo më

shumë për faktin se përse nuk jemi atje (në asnjë nga listat e cituara), por se ç'duhet të bëjmë për të synuar në ato renditje. Në kohë ky synim mund të ravijëzohet në të njëjtën linjë me atë që përcaktohet në direktivën e MM, posaçërisht për reformim të sistemit arsimor profesional ushtarak. Nisja ndoshta mund të bëhet duke hapur një debat për modelet (pasi nuk është një). Më tej, debati mund të shërbente si një referencë për objektivat që mund të rivlerësojmë. Në një periudhë të gjatë, veçanërisht, pas viteve '90, ndryshimet e thella në misionin dhe strukturën e FA, detyrimisht kanë kërkuar ndryshime në arsimimin profesional ushtarak. Periudha '90-2013 do të mbahet mend edhe si periudha kur janë tentuar të aplikohen disa modele të Arsimimit Profesional Ushtarak (APU). Por, si dëshmitarë okularë, modelet arsimore që duhet të reflektonin ndryshimet dhe objektivat, jo në çdo rast kanë arritur të shkojnë në harmoni me kohën kur ato

Në kërkim të modelit të arsimimit



Website i njohur OnlineCollege.org, ka realizuar listimin e "Top-10" për akademi / universitete ushtarake, por edhe kolegjeve/ akademive të mbrojtjes. Nga rreth 40 institucione që përmenden në këtë renditje, në tre listime nga agjenci të ndryshme, ato që qëndrojnë në vendet e para të renditjes janë akademitë amerikane, britanike, franceze, gjermane, italiane.

janë dashur që të pasqyroheshin. Më dendur modelet nuk arritën të kishin sukses, dhe, kjo jo për mangësi të përzgjedhjes, por ndoshta të mënyrës si i trajtuam dhe kërkuam të aplikojmë modelet dhe për atë aq pak kohë që ju dhamë për tu demonstruar. Pavarësisht nga fakti që modelet që tentuan janë nga më të famshmit në botë dhe janë tashmë kultura, kjo nuk ju dha atyre hapësirën dhe kohën për të shfaqur të njëjtën histori dhe standard. Sot në botë, në referencë me sistemin e APU njihen mjaft modele, të cilat kanë historinë e vet, sukseset apo dështimet. Studiuesi D. Vandergiff (West Point), e fillon renditjen historike për modelet më të suksesshëm me: modelin prusian, e më vonë atë frëng, britanik, rus, austriak, italian etj. Këto modele tashmë po kalojnë më shumë se 200 vjet dhe thuajse të gjithë kanë pasur mundësinë e të provuarit në teatrin operacional, në luftëra të ndryshme, kryesisht ato klasike, përfshirë edhe dy luftërat botërore. Interesant është edhe fakti që edhe modelet më të suksesshme kanë pasur edhe lëkundjet e veta (shih historinë). Është fakt se shumë vende, sot, aplikojnë një nga modelet e mësipërme në format tërësor apo të implemtuar me të njëjtat standarde dhe të përshtatur me kushtet konkrete. Tentativa për njohjen e këtyre eksperiencave kanë vlerën për mënyrën se si janë aplikuar dhe ndërthurur me kushtet specifike.

Për ne, ndoshta, do të jetë me interes që të shohim eksperiencën e vendeve relativisht të vogla, por që sot konkurrojnë suksesshëm në arenën botërore e veçanërisht në atë të Aleancës ku ne jemi pjesëmarrës, NATO. Dhe eksperiencat, modele ekselence të APU ka mjaft. Të tilla mund të jenë ato tradicionale: danez, holandez, belg e deri tek ata më të rinj si të vendeve baltike. Eksperiencat e deritanishme mundëson këdo, që ka marrë pjesë në misionet apo shtabe të NATO-s, që pa vështirësi mund të japë konsideracione ekselente për kolegët e vet perëndimorë: jo vetëm amerikanë, gjermanë, francezë, britanikë, por edhe ata danez, holandez, belg apo nga vendet baltike. Tu referohesh këtyre eksperiencave, sot, nuk ka vetëm vlerën e “kërshërisë”, por domosdoshmërinë për reflektim. Të zgjedhësh nuk është vetëm mundësi, por edhe përgjegjësi. Për një rast të tillë ndoshta vlen të kujtojmë atë që thotë Robert M. Hutchins – profesor filozofie në Universitetin Yale (SHBA)

1914, nxënësit e një shkolle ushtarake në Shkodër, në kohën e pushtimit austro – hungarez



kur shprehet se: “...lera e një modeli është zakonisht në proporcion të drejtë me faktin se sa mirë korrespondon me të shkuarën, të tashmen, të ardhmen, nivelin aktual apo potencial të mundësive dhe perspektivës...” dhe më tej ndoshta e përbashkët në njohjen dhe analizën e modeleve se “Modeli i arsimit nuk qëndron më tepër në reformimin e studentëve, në zellin e tyre apo për tu bërë ekspert të teknologjisë. Arsimi qëndron në turbullimin e mendjes, zgjerimin e horizonteve, ndezjen e intelektit, të mësuarit për të menduar drejt, sa më tepër që të jetë e mundur...”

Disa nga karakteristikat e përbashkëta të akademive dhe kolegjeve në perëndim

Referuar burimeve në internet, në një vështrim për modelin e arsimit profesional ushtarak (APU) në vendet e NATO-s (të paktën rreth 80% ose 21 nga 28) mund të arrijmë në disa karakteristika të përbashkëta.

Modelet:

- Vendet e NATO-s, dhe shumica e vendeve evropiane për arsimin profesional ushtarak i formatojnë institucionet në akademi apo universitete, në të njëjta standarde si gjithë sistemi i arsimit të lartë në vend (të tria ciklet e studimit).

- Institucionet që përgatisin dhe titullojnë oficerët e rinj emërtohen akademi/universitet ushtarak.

- Institucionet që përgatisin drejtues për strukturat e FA (mbi gradën major ose civil ekuivalent) emërtohen akademi/kolegje/universitete të mbrojtjes

- Në të gjitha vendet Akademitë ushtarake janë të ndara jo vetëm në strukturë por deri edhe fizikisht nga akademitë/kolegjet e mbrojtjes.

- Shumica e vendeve e organizojnë arsimimin ushtarak në specifika forcash (Forcat Tokësore; Detare; Ajrore), në struktura të akademive apo fakulteteve.

- Fakultetet me të spikatura në akademitë ushtarake janë: shkencat ushtarake, shkencat shoqërore, shkencat politike, shkencat ekonomike dhe inxhinieritë)

- Arsimi profesional ushtarak është pjesë e arsimit të lartë dhe institucionet arsimore ushtarake janë subjekte të proceseve të akreditimit, si të gjitha institucionet e tjera arsimore. Gati të gjitha institucionet e arsimit profesional ushtarak kanë përfunduar ose janë në proces të akreditimit (kolegjet dhe akademitë ushtarake në SHBA akreditohen nga institucionet e arsimit të lartë çdo 10 vjet. Kolegji i Luftës është akredituar për herë të parë në vitin 1973, Kolegji i Komandave dhe Shtabeve në vitin...dhe Ëest Point për herë të parë në vitin 1949 dhe përherë të fundit në vitin 2010). Akreditimi në sistemin e përgjithshëm arsimor konsi-

derohet objektiv madhor dhe realizimi i tij arritje mjaft e rëndësishme.

- Pothuajse se të gjitha institucionet e arsimit të lartë ushtarak (akademi/universitete) të vendeve të NATO-s zbatojnë parimet e Kartës së Bolonjës, ndërsa të gjitha vendet e BE organizojnë studimet sipas Kartës së Bolonjës.

- Akademitë / universitetet organizojnë programe në baze kreditesh ECT dhe njohin procesin e transferimit të krediteve.

- Gati, të gjitha akademitë / universitetet afrojnë të tre ciklet e studimit.

- Te gjitha vendet e BE janë të integruara gjithashtu në programin Military ERASMUS, në autoritetin e Parlamentit Europian, si konsorcium për bashkëpunim në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes (shih rezolutën 7395/10, 11 Mars 2010 të PE).

Kandidatet për oficerë

- Shumica e vendeve të NATO-s (90%) ndjekin praktikën e pranimit të kandidatëve pas përfundimit të arsimit të mesëm (nën moshën deri 21 vjeç). Britania, përveç kësaj mënyre afron edhe specifika.

- Kandidatët në Akademi vijnë nga shkollat e mesme ushtarake ose civile. Rreth 14 vende të NATO-s kanë më shumë se dy shkolla të mesme ushtarake në vend.

- Disa shtete për shërbime specifike (Anglia, Gjermania dhe Franca) marrin edhe studente që kanë mbaruar studimet bachelor, por vetëm me rezultate të shkëlqyera (vlerësimi A)

- Kandidatet për tu pranuar i nënshtrohen kryesisht testeve fizike, psikologjike dhe intervistave.

Në substancë të Direktivës së Ministres së Mbrojtjes dhe disa ide të mundshme për debat

Arsimi Profesional Ushtarak (APU) duhet t’ju përgjigjet ndryshimeve aktuale dhe atyre në vazhdim, në periudhën e eksplodimit të informacionit dhe teknologjisë, të ndryshimeve në pamjen dhe brendinë e konflikteve, por edhe vështirësive financiare, ndryshimeve në mjedisin e ri të sigurisë. Në mënyrë të pandërprerë, vizioni i arsimit profesional ushtarak duhet të ketë tërësisht një pamje të re, ndjenjë dhe përgjegjësi. Më e rëndësishmja, APU duhet t’i paraprijë ndryshimeve

me qëllim që duke siguruar e menaxhuar kapacitetet të ndikojë në përgatitjen dhe gatishmërinë e ushtarakëve për sfidat e ardhme me të cilat do të duhet të përballet siguria kombëtare. Ky është dhe fokusi i këtij shkrimi që nëpërmjet një qasje retrospektive të vlerësojmë impaktet gjatë realizimit të Direktivës së Ministres së Mbrojtjes, në çështje që lidhen me pozicionin dhe rolin aktual dhe perspektivë të APU për kapacitete e forcave tona të Armatosura. Do të ishte në interes të një përafrimi analitik që të realizojmë një vështrim, qoftë edhe të përmbledhur për modelet e realizimit të arsimit të ushtarakëve gjatë gjithë historisë së FA. Sistemi Arsimor në Forcat e Armatosura ka fillimet e veta që në periudhën e krijimit të shtetit shqiptar. Ai ka kaluar nëpër të njëjtin proces që kanë kaluar vetë FA. Objekti i kësaj trajtëse do të kufizohet kryesisht në dhënien e disa konsideratave për sistemin arsimor në periudha të ndryshme të shtetit shqiptar me synimin që duke njohur sadopak këtë përvojë mbi 100-vjeçare të qartësojmë idenë tonë për “...reformim të thellë të sistemit arsimor...”, siç parashihet edhe në Direktivën e Mbrojtjes 2014. Në fazën aktuale, duke njohur e diskutuar zhvillimet historike të sistemit arsimor, ky shkrim synon të adresojë këto ndryshime si referenca për reformime në sistemin për të përballuar presionin dhe sfidat bashkëkohore. Në qendër të shkrimit do të jetë analiza e modeleve ndaj do të përipiqemi të sjellim modele që kemi përdorur për të identifikuar e krahasuar vetveten në kohë të ndryshme. Ky shkrim konkludon duke afruar modele ku sistemi i arsimit mund të adresohet për të gjetur vetveten për tu përballur dhe paraprirë prioritetet e Forcave tona të Armatosura në Shekullin e 21. Është fakt i dukshëm, që përgjatë viteve sistemi i arsimit profesional ushtarak ka pësuar reformime të thella, jo vetëm për t’ju përshtatur ndryshimit të natyrës së luftës, por edhe specifikeve të vendit tonë apo edhe teknologjisë, në ndryshim të përhershëm. Koha, presioni për ndryshime, por edhe sfidat e shumta në fushën e mbrojtjes e më vonë edhe të sigurisë kanë vazhduar të nxisin sistemin e arsimit ushtarak për t’ju përshtatur kërkesave bashkëkohore.

... Vijnë numrin tjetër, me përfundimet dhe çështjet e ngritura për debat të hapur



Për ne, ndoshta, do të jetë me interes që të shohim eksperiencën e vendeve relativisht të vogla, por që sot konkurrojnë suksesshëm në arenën botërore e veçanërisht në atë të Aleancës ku ne jemi pjesëmarrës, NATO. Dhe eksperiencat, modele ekselence të APU ka mjaft. Të tilla mund të jenë ato tradicionale: danez, holandez, belg e deri tek ata më të rinj si të vendeve baltike.

KDS, zhvillohet ceremonia e daljes në pension e Ajet Nurellarit

Në mjesditet e QD, në datë tre mars 2014, u zhvillua ceremonia e daljes në pension e zotit Ajet Nurellari. Ceremonia e organizuar nga i gjithë stafi i QD, përkoi edhe me 65-vjetorin e lindjes së tij. Në këtë ceremoni morën pjesë zëvendëskomandanti i KDS-së, kolonel Ruzhdi Kuçi, drejtues të institucioneve, profesorë, miq e kolegë, etj. Në fjalën e hapjes të mbajtur me këtë rast nga Shefi i QD, kolonel Ahmet Leka, ndër të tjera u vlerësua maksimalisht puna ndër vite e zotit Ajet Nurellari. Diskutime të lira dhe fjalë zemre pati dhe nga kolegë e bashkëpunëtorë të Ajetit. Kolegu i tij dhe shoku ndër vite, njëkohësisht edhe drejtori i QLMI-së, profesor Bernard Zotaj, duke përmendur punën e përbashkët ndër vite tek "Revista Ushtria" është shprehur me mjaft ndjenjë, duke vlerësuar punën e gjatë në këtë organ botues. "Ju arritët të ndërtoni një profil të qartë dhe të spikatur të një personaliteti në fushën e gjuhësisë, në veçanti asaj ushtarake. Ndër vite keni demonstruar dukshëm përkushtim, rigorozitet, profesionalizëm, integritet dhe vëmendje maksimale ndaj çdo punimi, duke shfaqur pasion për punë dhe seriozitet" - përfundoi, Profesor Zotaj. Gjithashtu, bashkëpunëtori dhe miku tjetër, kolonel (r) Vait Golikja, lexoi për të gjithë të pranishmit urimin e sinqertë të së gjithë stafit të QD, si për 65-vjetorin e Lindjes ashtu dhe për daljen në

pension: "Mirënjohje, respekt dhe lumturi - Kohën e qëndrimit në punë e përfunduar me nder, me respekt, me dinjitet dhe me mirënjohje nga të gjithë. Urime edhe për 65-vjetorin e lindjes, një jetë sa më të mirë me familjen e shtrenjtë". Nën ndjenjat e emocioneve të forta, Zoti Nurellari falënderoi ngrohtësisht për organizimin e kësaj ceremonie, falënderoi për bashkëpunimin, frymën e kolektivitetit e mirëkuptimit të gjetur, me ndikim pozitiv në realizimin e detyrave të ngarkuara në punën e tij. Në emër të SHSHPPFA, zëvendëskomandanti i KDS-së kolonel Kuçi, i dorëzoi Zotit Ajet Nurellari, "Certifikatën e Mirënjohjes" me motivacionin: "Për kontributin e dhënë për më shumë se 40 vjet në FARSH dhe për profesionalizmin e lartë në fushën e zhvillimit të mendimit ushtarak". Mirënjohja, respekti, falënderimi për të vlerësuar mbi 40 vjet punë, përpjekje e përkushtim, u konkretizua gjithashtu edhe në një tjetër "Certifikatë Mirënjohje" për zotit Nurellari, të akorduar nga zëvendëskomandanti i KDS, kolonel Kuçi. Më pas, të gjithë të pranishmit në ceremoni, ndoqën një dokumentar mbi punën dhe veprimtarinë e zotit Ajet Nurellari. Ceremonia u mbyll në realizimin e një fotoje dhe kokteji të përbashkët me të gjithë të ftuarit, si dhe me urimin për 65-vjetorin e Lindjes.



QNOD, takim pune ndërinstytucional

Peshkimi, synohet rritja e sigurtisë në det dhe zbatimin i ligjshmërisë

Më datën 5 mars 2014 në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) u zhvillua një takim pune për rritjen e sigurtisë në det dhe përmirësimin e kuadrit ligjor nga mjetet tona të peshkimit. Në takim morën pjesë drejtori administrativ i QNOD, zoti Maksim Malaj, koordinatorët e institucioneve përbërëse të Qendrës si dhe zotërinjtë Arjan Demiraj, drejtor i Shërbimeve Peshkore dhe Akuakulturës në Ministrinë e Bujqësisë dhe Aleksandër Klimi, specialist në këtë Ministri. Fillimisht zoti Malaj theksoi rëndësinë e rritjes së sigurtisë në det për mjetet tona të peshkimit, përmirësimin e kuadrit ligjor për këtë çështje dhe në këtë kuadër forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional, ku secili ka detyrat e përgjegjësitë e veta. Ndaj qëllimi i këtij takimi është gjetja e mënyrave efikase për zbatimin e ligjit Nr.29/2013, si dhe VKM-të e miratuara në zbatim të këtij ligji. Me rritjen e kapaciteteve operacionale të QNOD për monitorimin e situatës detare është emergjente evidencimi i nevojave kryesore për zbatimin e ligjit, standardizimit të procedurës për dhënie dhe marrjen e informacioneve dhe ndarjen e përgjegjësiave midis strukturave përkatëse për mbarëvajtjen e këtij procesi më rëndësi ekonomike për vendin. QNOD nëpërmjet personelit të shërbimit dhe sistemeve SIHVD e Blue-Box, monitoron aktivitetin e peshkimit, i cili aktualisht ka një problematikë të shumtë që nga peshkimi i paligjshëm në zonat e ndaluara, zonat e mbrojtura, thellësitë, peshkim me lëndë plasëse, regjistrimi e identifikimi i mjeteve të peshkimit, emri në bord, flamuri, rajoni i peshkimit, koha, itinerari, raportimi i hyrjes dhe daljes nga zona me regjim peshkimi të kufizuar nëpërmjet sistemit operacional në çdo 30 minuta, shpejtësia, sasinë e mallit të mbajtur në bord, raportimi në dalje, zonën gjeografike përkatëse të gjuetisë, emrin e portit të mbërritjes, arsyen e ndalimit, detyrimet e anijeve me flamur të huaj, sanksionet në rastet e shkeljes së ligjit, etj. Aktualisht personeli përkatës në QNOD e ka të vështirë të ndjekë numrin e madh të mjeteve që dalin për peshkim, ndaj



është e nevojshme gjetja e formave dhe mënyrave të reja, nënvizoi zoti Malaj. Ndërkohë zoti Demiraj vlerësoi takimin e organizuar, ku interesi për monitorimin e flotiljes së peshkimit dhe vënien e këtij procesi me rëndësi ekonomike në vend mbi baza ligjore është i përbashkët. Ne jemi duke rishikuar legjislacionin përkatës, veçmas pjesën e inspektoratit e masave ndëshkimore, ndaj na sillni mendimet e sugjerimet tuaja për këtë tha drejtor Demiraj. Jemi duke krijuar "database" për të gjitha anijet e mjetet e peshkimit, sipas përmasave, tonazhit, llojin e peshkimit, theksoi specialisti i MB Aleksandër Klimi, dhe këto informacione brenda muajit mars do ju jepen institucioneve përgjegjëse dhe QNOD. Është i nevojshëm informimi i ndërsjellë, pikat e bashkëpunimit, trajnimi i personelit dhe zbatimi i rregullave nga të gjithë palët theksuan përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë. Gjatë takimit u tha se ka me dhjetëra shkelje nga mjete e peshkimit, por asnjë masë dhe sanksion. Do shtohen masat e sanksionet për mjetet që gjuajnë me dinamit apo bëjnë kontrabandë. Anijet e Rojes Bregdetare, Policisë Kufitare apo Antikontrabandës janë të gatshme në çdo kohë për ti ndi-

hmuar në rast rreziku mjetet peshkatore, qoftë edhe kur shkelet ligji. Por çdo dalje e tyre ka një kosto, dhe kjo kosto do mbulohe nga shkelësit e ligjit. Sistemi BlueBox dhe kontrolli i ushtruar nga Policia Kufitare vitin e kaluar ka evidencuar probleme të ndryshme të dokumentacionit, gatishmërisë teknike, identitetit të këtyre anijeve, pronarëve, ndaj duhet një verifikim total i tyre, theksuan pjesëmarrësit në takim. Janë mbi 700 mjete peshkimi që operojnë në hapësirat tona ujore. Ndërkohë që heqja e moratoriumit do ketë tendencë shtimin e numrit të këtyre mjeteve. Për realizimin me sukses të kësaj detyre do bashkëpunohet ngushtësisht që nga Drejtoria përkatëse në Ministrinë e Bujqësisë, Administratën Detare, QNOD, Forca Detare, Policia Kufitare dhe Regjistri Detar. Palët janë të detyruara të bashkëpunojnë dhe informojnë njëra tjetër. Në takim u la detyrë që së afërmi të organizohet një takim në nivel ekspertësh ku të diskutohen e vendosen problemet që kanë të bëjnë me rritjen e sigurtisë lundrimore dhe zbatimit të ligjit nga mjetet tona të peshkimit. Dhe për këtë shteti shqiptar i ka mundësitë dhe institucionet përkatëse.

Shefqet Kërçelli

OFFA , debutim i shkëlqyer në zemër të kryeqytetit

Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura me rastin e hapjes së stinës koncertore ka performuar për herë të parë në jetën e aktiviteteve artistike-kulturore të Kryeqytetit me një format të ri me anë të një komunikimi ndryshe të një aktiviteti cilësor duke i dhënë jetë dhe dritë hollit të koncerteve në Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit duke bërë zhvendosjen e vëmendjes për një publik të zgjedhur, duke dhënë një koncert recital të formacioneve të vogla. Orkestra Frymore të FA tashmë në gjirin e saj mban formacione , si kuintete, sekstete të ndryshme, të cilat performojnë "live" dhe me një gamë të gjerë të repertorit artistik. Publiku që ndoqi këtë eveniment e priti me një dashamirësi dhe me një ovacion performancën dhe lojën e shkëlqyer të këtyre formacioneve të muzikës së dhomës. Formacioni i parë që hapi siparin e kësaj mbrëmjeje ishte ansambli i harqeve, tashmë i njohur për një serë aktivitetesh të gjerë koncertesh me vepra të njohura të autorëve shqiptarë dhe vepra nga autorët klasik e botëror. Prezantimi me veprat e kompozitorëve të njohur botëror si W. A. Mozart me tre kohët e "Divertimento" in F. J. Brahms me "Hungarian dance nr 5", A. Dvorzhak me "Slavonic dance nr 8", i dha kësaj mbrëmjeje një emocion të veçantë, gjithashtu vepra "Nina-Nana" e Feimi Brahimit, si dhe "Palladio" në mbyllje nga Karl Yenkis i dha një prezantim dinjitoz këtij ansambli duke marrë duartrokitjet e të ftuarve në këtë mbrëmje kaq të bukur. Më pas kuinteti i frymës një formacion i sapo ngritur performoi nga G. Bizet Suiten "Karmen Seguidille" si dhe "Berberin e Seviglias", nga i famshmi Rossini. Gjatë interpretimit të këtyre artistëve të rinj u ndje linja artistike dhe loja në grup e të pesë instrumentistëve, në veglat klarinetë, flaut, fagot, oboe dhe corno. Prezantimi i këtyre veprave të mëdha nga ana e këtyre artisteve i dha një hijeshi dhe një trajtim ndryshe lojës në kuintet, pasi veprat janë për orkestra simfonike, por të përshtatura për kuintet, frymë ku secili nga instrumentistët do merrte rolin e luajtjes të instrumenteve të para në një orkestër simfonike. Formacioni i saksave pati nderin ta mbyllte këtë natë të paharruar për auditorin, i cili u shtang me mënyrën e interpretimit dhe të lojës në veglat e saksit, si atyre tenor e bariton ashtu dhe të saksave sopran dhe alto. Programi i zgjedhur la të kuptonte për një përkushtim dhe prezantim sa më dinjitoz të veprave duke filluar me një potpuri këngësh shkodrane si dhe vepra nga autorë të njohur si G. Gerzhëin me "Un amerikano a Parisi", Ramirez me "Jericho" apo nga I. Volante "Saxs per sei". Difuzimi i zërave të lojës në saks dhe loja e pastër artistike i dha këtij ansambli dhe të ftuarve kënaqësinë të bëhen pjesë e marrjes të ovacioneve dhe dhënies së duartrokitjeve të vazhdueshme nga publiku, i cili ishte i një niveli të lartë, dhe vlen për tu përsëndetur. Në fund të kësaj mbrëmjeje artistike u mbyll me një kolazh këngësh Arbëreshe të shkruara enkas për formacion saksash. Mbrëmja kishte dhe të ftuarit e saj si nga atashetë e ambasadave të huaja, ashtu dhe dashamirës të artit që vijnë nga radhët e Forcave të Armatosura. Tashmë "Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura", përveç detyrave të saj, po bën edhe mbulimin me jetë artistiko-kulturore në formën e koncerteve recital, sidomos të muzikës së dhomës për një publik më të zgjedhur duke qëndruar në lartësinë e duhur për edukimin nëpërmjet artit në kryeqytet dhe në rrethet e tjera të vendit tonë.



Arben Muça, Udhëheqës Artistik

Albert Hitoaliaj

Ukraina, fat i parathënë nga gjeografia...

Pas një vonese të pritshme, në vitin 2009 Rusia miratoi Strategjinë e re Kombëtare të Sigurisë, e cila është edhe ajo aktualja. Kjo strategji që do të jetë e vlefshme deri në vitin 2020, u mirëprit si një dokument novator e i dobishëm që qartësonet parimet udhëzuese të politikës së brendshme e të jashtme. Funkzioni më i spikatur i kësaj strategjie është miratimi i një qasje të shëndoshë ndaj sigurisë, që përbëhet nga dy prioritete, ai i mbrojtjes dhe ai i politikave sociale. Ndryshimet në këtë doktrinë, ecin paralel me ndryshimet në mjedisin e sigurisë dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare si dhe me synimin e pa-braktisur të Rusisë, që të zërë vend kryesor në hapësirën ndërkombëtare. Fuqizimi dhe dominimi janë qëllimet kryesore të Rusisë, edhe pse arritjen e tyre e synon nëpërmjet mjeteve që ndryshojnë nga ato të Luftës së Ftohtë. Doktrina thekson planet e Rusisë për t'u bërë një "fuqi rajonale" e të hyjë në klubin e pesë ekonomive udhëheqëse botërore dhe pohon se kontrolli mbi rezervat e energjisë mund të çojë te përdorimi i forcës. NATO-ja dhe SHBA-ja vazhdojnë të perceptohen aty, ende si kërcënimet kryesore për sigurinë kombëtare, edhe pse ato kanë ofruar një partneritet të kushtëzuar. Kjo doktrinë ishte fryt i një pune pesë vjeçare. Procesi i hartimit të Strategjisë të Sigurisë Kombëtare, dokumenti bazë i zhvillimit të fuqisë kombëtare, filloi në vitin 2004. Pas luftës me Gjeorgjinë, Presidenti Medvedev kërkoi finalizimin e dokumentit. Në fund të marsit 2009 Doktrina e Sigurisë, e cila ishte pothuajse gati për t'u miratuar, u vonua për shkak të kërkesës së Medvedevit për disa përsosje të mëtejshme.

Në fund, një dekret presidencial, më 12 maj 2009 miratoi pas kalimit të afatit, Strategjinë Kombëtare të Sigurisë të re të Rusisë deri në vitin 2020, duke zëvendësuar në këtë mënyrë atë që më parë quhej Konceptimi, i hartuar në 1997 dhe i freskuar në vitin 2000. Edhe pse strategjia e re ka elementë të cilët e orientojnë sigurinë kryesisht drejt ekonomisë dhe fuqizimit të kësaj të fundit nëpërmjet shfrytëzimit të burimeve dhe përdorimit të tyre për të shtuar influencën globale në sferën e sigurimit të energjisë, përsëri perceptimi rus ndaj Perëndimit e më saktësisht ndaj NATO-s dhe ndaj SHBA-së nuk ka ndryshuar thuasje fare. Sipas doktrinës ruse, NATO dhe SHBA mbeten kërcënime të fuqishme të sigurisë. Strategjia aktuale konfirmon qëndrimin negativ tradicional të Rusisë për zgjerimin e NATO-s drejt Lindjes, dhe ndaj përpjekjeve të SHBA-së për uljen e potencialit bërthamor të Rusisë, duke krijuar sistemin e mbrojtjes anti-raketore në Evropën Qendrore, dhe frikën për zgjerimin e hendekut ushtarak e teknologjik me SHBA-në (pavarësisht nga përcaktimi i fundit i Rusisë për të forcuar aparatit ushtarak). Ndër të tjera formulimi i SKS-së ruse thotë:

"Një arkitekturë globale e sigurisë e orientuar ekskluzivisht drejt NATO-s, është e detyruar të dështojë" dhe, Rusia "nuk do të ulë vigjilencën e saj në lidhje me planet e NATO-s për të zhvendosur infrastrukturën ushtarake më pranë kufijve të saj dhe përpjekjet për t'i dhënë Aleancës një karakter global, gjë që është shkelje e të drejtës ndërkombëtare".

Pavarësisht qëndrimin negativ në këtë drejtim dhe perceptimit të NATO-s si kërcënim, tashmë duket qartë se Rusia ka vënë në përdorim mjete të tjera, për fuqizimin e saj dhe për t'u ri-ngritur si aktor imponues në sferën e sigurisë. Siguria e energjisë – kjo është fuqia të



e cila Rusia do të marrë shtysën për të ecur më shpejt dhe për t'u pozicionuar më mirë në hapësirën e sigurisë.

Paragrafi 9 i Doktrinës thotë: "ndryshimi nga konfrontim në bllok në parime të diplomacisë multi-vektoriale dhe potencialet e burimeve [natyrore] të mundshme të Rusisë, së bashku me politikën pragmatiste të përdorimit të tyre kanë zgjeruar mundësitë e Federatës Ruse për të forcuar ndikimin e saj në arenën botërore".

Paragrafi 47 bën lidhjen mes energjisë dhe sigurisë kombëtare: "Burimet e rrezikut për sigurinë kombëtare mund të bëhen faktorë të tillë si intensifikimi i betejës për burimet natyrore, mes tyre energjia, uji dhe mallrat e konsumit".

Autorët e Strategjisë besojnë se çështja e energjisë dhe konkurrenca ndërkombëtare për akses dhe kontroll të pasurive të hidrokarbureve do të jenë shqetësimi kryesor në çështjet botërore të së ardhmes së parashikueshme. Dokumenti përcakton madje, edhe se ku do të zhvillohen betejat e mëdha gjeopolitike energjetike: Lindja e Mesme, Shelfi [lexo: sergjen] i Detit Barents, Azia Qendrore dhe Arktiku. Natyrisht, burimet e saj të shumta e pozicionojnë Rusinë në mënyrë të favorshme dhe me kalimin e viteve ajo ka realizuar një rritje ekonomike të dukshme. Parë në këtë kënd, ajo po fuqizohet. A ka arsye Rusia që të ndihet e kërcënuar nga një sistem, i cili po i sjell asaj më tepër siguri ekonomike? Kërcënimet që i "kanosen" tashmë ajo i ka deklaruar qartë: NATO dhe SHBA. Arsyet është vështirë që të shihen. Ndoshta, pas këtij "shqetësimi" fshihet ndryshimi që po ndodh me Rusinë.

Strategjia aktuale Kombëtare e Sigurisë, e miratuar në vitin 2009, është pasuar edhe nga Doktrina e re Ushtarake e firmosur nga presidenti Medvedev në janar 2005. Do të ishte e tepërt të përsëriteshin kërcënimet që rusët konfirmojnë në këtë dokument. Rastin e parë për të ngritur shqetësimet e tyre, menjëherë pas miratimit të këtyre dokumenteve bazë të Sigurisë Kombëtare, rusët e shfrytëzuan në Mynih, në fillimin e shkurtit 2010. Gjatë dekadave të fundit, konferenca e

Mynihut për Sigurinë është bërë konferenca mbarë botërore më e madhe për politikën e sigurisë. Çdo vit ajo bashkon figura të larta nga e gjithë bota për t'u angazhuar në një debat intensiv mbi sfidat e sigurisë aktuale dhe ato të së ardhmes. Qëllimi i kësaj konference është që të mbajë këtë standard të lartë ndërkombëtar dhe të rrisë profilin e tij edhe më shumë. Konferenca e Mynihut për sigurinë vazhdon të drejtojë çështjet kryesore të sigurisë për kohën tonë. Në të debatohet dhe analizohen sfidat kryesore të sigurisë, ndërsa në të njëjtën kohë shikohet vazhdimisht përpara në mënyrë që të trajtohen çështjet e të ardhmes në një fazë të hershme. Qëllimi i konferencës së Mynihut për Sigurinë, është që të mbetet forumi më i rëndësishëm i pavarur për shkëmbimin e pikëpamjeve të vendimmarrësve ndërkombëtarë të politikës së sigurisë. Rusia e përdori fazën e konferencës së Sigurisë 2010 në Mynih për të "fshikulluar" zgjerimin e NATO-s në lindje. Përgjigjja e Aleancës Perëndimore, po në këtë Konferencë, prej Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Anders Fogh Rasmussen ishte e shpejtë duke shfaqur qëndrimin e Aleancës ndaj Moskës, e duke e konsideruar pozicionin e kësaj të fundit si jo të ankoruar aq sa duhet në botën e vërtetë. Ministri i Jashtëm rus, Lavrov, që në paragrafët e parë të fjalës së tij në Konferencën e Mynihut shpalli haptazi pakënaqësinë e Rusisë për zhvillimet në fushën e sigurisë:

"Ndryshimet dramatike në botë gjatë njëzet viteve të fundit nuk mund të mos kenë ndikim në agjendën ndërkombëtare. Tani ne po ballafaqohemi me çështjen e transformimit dhe të ndryshimit të saj. Përmirësimi i dukshëm në atmosferën e politikës Euro-Atlantike, ku kërkesa për qasje ballafaqese ka rënë seriozisht, nxit gjithashtu këtë gjë. Por është e vështirë për ta quajtur normale gjendjen ku realitetet politiko-ushtarake në zonën Euro-Atlantike janë shumë më pas proceseve bashkëkohore të tregtisë, ekonomisë, teknologjisë, investimeve dhe proceseve të tjera të globalizimit e të ndërvarësishë, që ndodhin në botën e sotme. Gjatë njëzet viteve të fundit, siguria Evropiane është dobësuar rëndë në të gjithë parametrat.

Kjo vlen si për regjimin e kontrollit të armëve e konflikteve të vazhdueshme edhe për përpjekjet për t'i kthyer "konfliktet e ngrira" në "të nxehta" dhe për gjykimin e OSBE-së. Shprehitë se "çdo gjë është normale, asgjë nuk ka nevojë të ndryshohet" nuk na bindin. Shpresoj se pikëshikimi ynë do të dëgjohet."

Shqetësimi kryesor i përmendur, nga Lavrov, shqetësimi i cili qëndron edhe në dokumentet bazë të sigurisë së shtetit rus, ishte se Evropa dhe Shtetet e Bashkuara, duhet ta përfundojnë "qasjen e tyre bllok" ndaj sigurisë, të bazuar te NATO-ja dhe në vend të kësaj, të nënshkruajë propozimet e Rusisë për një sistem të ri të sigurisë. Ky ishte qëndrimi i patundur i ministrit të jashtëm rus, Sergei Lavrov, gjatë fjalës së tij në 6 janar 2010, para delegatëve të pranishëm në konferencën e Sigurisë në Mynih:

"Me shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik dhe Organizatës së Traktatit të Varshavës lindi një mundësi e vërtetë për ta bërë OSBE-në një organizatë plotësisht të zhvilluar, që do të garantonte siguri të njëjtë për të gjitha vendet e zonës Euro-Atlantike. Megjithatë, kjo mundësi ka humbur, sepse zgjedhja u bë në favor të politikës së zgjerimit të NATO-s, gjë që do të thoshte jo vetëm ruajtje e linjave që ndanin Evropën gjatë Luftës së Ftohtë në zona me nivele të ndryshme sigurie, por gjithashtu edhe shtyrje e këtyre linjave në Lindje. Roli i OSBE-së, në fakt, u reduktua për t'i shërbyer kësaj politike me anë të mbikëqyrjes së çështjeve humanitare në hapësirën post-sovjetike. Si rezultat, një arkitekturë evropiane që do të bashkonte të gjitha shtetet e hapësirës Euro-Atlantike pa përjashtim, në një organizatë të bazuar te logjika, te parimet ligjore detyruese dhe te mjetet e përshtatshme për t'i siguruar këto praktikisht, nuk u materializua. Shformësimi i natyrës së OSBE-së çoi në izolimin e saj prej nevojave të jetës së vërtetë në shumë fusha."

Mes arsyeve të sjella nga Lavrov, të cilat pasqyrojnë edhe shqetësimet ruse të përmendura më sipër, shikohet një kundërshti e ndërmjetme. NATO-ja,

Organizata e Traktatit të Varshavës, por gjithashtu edhe OSBE-ja, janë të tria prodhim i të njëjtës rrjedhë historike botërore. Nëse akuzohet Perëndimi për faktin se nuk dështoi, atëherë ky është një paradoks; nëse NATO-ja duhet të shpërbëhej pas Luftës së Ftohtë [ashtu si Organizata e Traktatit të Varshavës] kjo ishte dhe është në varësi të vullnetit të lirë të vendeve pjesëmarrëse në të e jo në varësi të ekuilibrit mekanik të forcës. Organizata të cilën kërkojnë rusët, nuk është një OSBE më dinamike, por një organizatë e përbashkët e aktorëve më të fuqishëm të mjedisit të sigurisë ku ata të kenë mundësinë të jenë aktorë kryesorë. Ky imazh mund të ishte i ngjashëm me atë të Këshillit të Sigurimit në OKB. Në këtë pikë, në kërkesën e ndryshimit të sistemit global të sigurisë, ata duket se shikojnë në të njëjtin drejtim që shikon edhe Perëndimi: ndërtimi i një rendi të ri botëror. Mbi mënyrat e ndërtimit të këtij rendi duket se do të diskutohet shumë, nisur edhe nga mënyra se si Rusia e konsideron hapësirën Euro-Atlantike. Rasti i Kosovës konsiderohet nga vendet e NATO-s si një ndërhyrje e cila, jo vetëm që ishte e suksesshme, por edhe plotësisht e motivuar, kundër një gjenocidi të pashembullt të ushtruar kundrejt popullsisë shqiptare nga forcat ushtarake serbe. Por, kjo ndërhyrje, sipas mendimit rus, ishte jo vetëm e gabuar, por edhe e dështuar për sa i përket drejtimin të sfidave të mjedisit të sigurisë. Shembulli tjetër [bazuar te shembujt e Lavrovit] është ai i Osetisë së Jugut. Legjitimiti që ai i bën ndërhyrjes ruse, nuk e zbeh aspak kujtesën së si e priti Perëndimi qëndrimin rus. Në këtë rast, NATO-ja i ftoh marrëdhëniet për shkak të luftës ruso-gjeorgjiane, e cila pa të angazhuar të tërë aktorët kryesorë të mjedisit të sigurisë në një thirrje për paqe. Interesat gjeopolitike të Rusisë e shtyjnë atë që të kritikojë tërë mënyrën e organizimit të çështjeve të sigurisë. Pikërisht këto arsye gjeopolitike – aspak e drejta ndërkombëtare apo prirja për një botë më të sigurt – bëjnë që Rusia të ketë ide të pandryshueshme ndër vite, ashtu siç shprehej edhe Lavrov:

"Që parimi i pandashmërisë së sigurisë në OSBE nuk punon, nuk do shumë kohë për t'u provuar. Le të kujtojmë bombardimin e Republikës Federale të Jugosllavisë në vitin 1999, kur një grup i vendeve të OSBE-së, të lidhur prej kësaj deklarate politike, u angazhuan në një agresion kundër një vendi tjetër të OSBE-së, i cili mbulohej gjithashtu nga i njëjti parim. [...] Kosova dhe Osetia e Jugut, janë që të dyja manifestime të dobësisë sistematike të OSBE-së. [...] Por unë gjithashtu dua të them një gjë tjetër. Gjatë zhvillimit historik, kemi ardhur në një kohë ku po ndodhin ndryshime serioze dhe ne duhet të zgjedhim mes të kaluarës dhe të ardhmes. Përgjithësisht, kjo është edhe çështja aktuale. Është e rëndësishme që të mos humbet ky moment unik. Unë jam i sigurt se ne jemi në gjendje të ngrihem mbi komplekset historike dhe "të shikojmë përtej horizontit."

Ngjarjet aktuale në Ukrainë janë pjesa e dukshme e ngjizjes së Rendit të Ri Botëror, rendi i cili bazohet te pandryshueshmëria e gjeografisë. Këtë rend po e shkruan gjeopolitika dhe nuk ka asnjë gjasë që të jetë ndryshe. Logjika e thjeshtë gjeografike e Mackinder, Houshofer apo Spykman më pas, duket se gjendet edhe sot e reflektuar në libra serioze si ai i Robert Kaplan "Hakmarrja e Gjeografisë", mesazhi i të cilit është i qartë: shikoni hartat dhe do kuptoni fatin dhe konfliktet e ardhshme. Shikoni hartat dhe kuptohet se ç'po ndodh në Ukrainë, ashtu siç kuptohet edhe ajo që ndodh vazhdimisht në Shqipëri – quhet ndikimi i gjeografisë mbi histori, ose gjeopolitike.

Kur (ri)lindte Kosova...

Me veteranët e Luftës e të Ushtrisë, 15 vjet më parë në divizionin e Kukësit

NGA KOLONEL (R) SALI ONUZI*

15 vjet më parë, me 3 mars 1999 media e shkruar dhe elektronike njoftonte se një grup veteranësh të luftës e të ushtrisë, ish gjeneralë dhe oficerë madhorë të Ushtrisë shqiptare qenë nisur për një vizitë në zonën verilindore të Shqipërisë. Shqipëria po përkujtonte 55 vjetorin e i Çlirimit të saj nga pushtuesit nazifashistë në një atmosferë të pazakontë: në hapësirat mitike të Ballkanit, në Kosovë kish kohë që me gjithë egërsinë e tyre kishin zbritur falangat e ushtrisë serbe. Edhe barbarët historikë andej kishin ardhur. Pas një viti lufte, spastrimi etnik e gjenocidi në Kosovë, (si masakra e Reçakut me 15 janar 1999) Jugosllavia nuk pranoi ta nënshkruante dokumentin e Konferencës Ndërkombëtare të Rambujesë (6-21 shkurt 1999). Në terrenin e Kosovës, njëkohësisht fuste forca e mjete të blinduara. "Ushtria serbe po vazhdonte lëvizjen në drejtim të Kosovës. Korpusi i Prishtinës u përforcua me rezervistë me njësi elite të këmbësorisë e me helikopterë, me artileri të rëndë e me njësi të blinduara të klasit të parë nga veriu i Serbisë." (Wesley Clark "Të bësh luftë moderne". Prishtinë, 2003, f.202) Ky grumbullim forcash dhe mjete kish për shënjestër shqiptarët, UÇK dhe civilët. Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë shqiptare që ndiqnin me vëmendje situatat në Kosovë kishin marrë e merrnin masa për të forcuar mbrojtjen e kufirit shtetëror. Veteranët e Shqipërisë kishin shprehur dëshirën të bënin një vizitë në Divizionin e Kukësit. Dhe ja, me interesimin personal të ministrit të Mbrojtjes zotit Luan Hajdaraga dhe me kërkesën e vet komandantit të divizionit të Kukësit gjeneralbrigade Kudus Lampe, kjo vizitë po bëhej. Jo thjesht nuk dikush në një inspektim politik nuk kish konstatuar gatishmëri në kufi, meqë nuk kish hasur në rrugët e asfaltit asnjë batalion e kompani!. Këto flluska sapuni mund t'i shponte edhe artikulli i një gazetari të "Ushtrisë". Le që populli ish vetë aty dhe nuk e hante sapunin për djathë. Shkuarja e grupit të veteranëve të luftës e të ushtrisë duhej të kish, siç edhe pati në fakt motive shumë më të thella. Lufta po zhvillohej në Kosovë. NATO kish paralajmëruar jo njëherë Milloshevicin. Jo vetëm profesionistët e politikës e të sigurisë kombëtare, por edhe njerëzit e thjeshtë po e shihnin se lufta po na trokiste në derë. Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë kishin zbritur në Kukës, Has e Tropojë. Një pjesë e mire e tyre qenë instaluar aty në terren dhe ndiqnin me kujdes të madh situatën dhe masat që merreshin. Por Shqipëria i kishte gjallë brezin e atyre që kishin bërë Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare kundër pushtuesve nazifashistë. Këta burra kishin organizuar një ushtri e një mbrojtje për rast lufte. Terrenin, fortifikimin, brezat, mundësitë e mbrojtjes e të vendosjes i kishin në hartat e mendjes të ngulitura. Të gjithë emra të njohur: Rrahman Parllaku (Hero



"Ushtria serbe po vazhdonte lëvizjen në drejtim të Kosovës. Korpusi i Prishtinës u përforcua me rezervistë me njësi elite të këmbësorisë e me helikopterë, me artileri të rëndë e me njësi të blinduara të klasit të parë nga veriu i Serbisë." (Wesley Clark "Të bësh luftë moderne")

i Popullit), Sadik Bektashi (Hero i Popullit), Halim Ramohito, Muharrem Kokomani, Zeqiri Mero, Sejdin Avdia, Thoma Xhixho, Dilaver Poci, Adnan Qatipi, Qamil Poda, Enver Begeja, Veli Llakaj, Tefik Ruci, Nikollaq Sallabanda, Kapo Kapaj, Muharrem Mulgeci, Gjergj Titani, Nexhmi Menzelxhiu, Faiko Zaimi. Të gjithë bashkë, pa asnjë ndasi politike e partiake, ishin nga ata burra që bënin pjesë në "partinë" e Kombit. Dhe ndodhi ashtu siç pritej. Vizita e tyre u prit me një interesim të madh në gjithë Shqipërinë e ne veçanti në verilindje Media qendrore dhe lokale bënë punën e tyre të mirë. Në Kukës, komandanti i Divizionit dhe Shtabi i tij, shoqëruar nga media lokale kishin dalë t'i prisnin që në Fushë-Dukagjin dhe që atë mbrëmje TV Kukësi zhvilloi e transmetoi me veteranët një bisedë rreth synimeve të veteranëve në vizitën e tyre. Plot qytetarë para hotel "Gjallicës" që pyesin e takonin njërin a tjetrin. Më të papërmbajturit futeshin edhe në hotel a restaurant për një kafe me veteranët, me ish komandantët e tyre të dikurshëm etj. U kuptua menjëherë se edhe në planin moral e shpirtëror vizita e veteranëve kishte qenë një gjetje e mrekullueshme. Provokacionet serbe në kufirin tonë shtetëror, gjithnjë më të shpeshta e më të rrezikshme, s'kishte si të mos ngjallnin tension, irritim, edhe një lloj padurimi. Kur serbët kishin hapur zjarr ndaj postës sonë të Morinit dhjetëra fshatarë shqiptarë ishin gjetur të armatosur në postë përkrah policëve tanë dhe i ishte dashur autoriteti i komandantit të Divizionit, gjeneral Kudus Lampe t'i qetësonte e përmbante të mos kalonin kufirin. Vetëpërmbajtja kish qenë dhe do të ishte qëndrimi ynë për të mos rënë në kurthin e provokacioneve serbe që përhapnin nëpër Botë shpifjet sikur nga Shqipëria eksportohej terrorizmi, UÇK-ja dhe destabilizimi i Jugosllavisë. Programi dyditor i vizitës u realizua plotësisht. Më 4 mars grupi që në mëngjes do të ishte në sallën e Shtabit të Divizionit për tu njohur me gjendjen. Ndodhi që në fillim të veprimtarisë të njoftohej

për një provokacion serb në kufi në fshatin Letaj të Hasit. Që këtu veteranët u futën në një situatë reale, ku ra në sy vetëpërmbajtja, logjika dhe gatishmëria e tyre. U nis kolonel Selim Spahiu, shef i Shtabit me një grup dhe shpejt u njoftua se çdo gjë ishte zgjidhur. Atë ditë veteranët vizituan Brigadën e Metori (sot Fusha e aviaçionit). U takuan me të gjithë ushtarë, nënoficerë e oficerë, aty në postet e tyre luftarake, pranë topave, tankeve, transportuesve të blinduar, raketave dhe armëve të tjera. Pastaj vizituan regjimentin e artilerisë tokësore në Bicaj dhe pikën kufitare të Morinit në Bicaj pranë topave ishin gati kompletet e predhave luftarake, gradimet të vendosura dhe ujërat e niveluar. Pritej vetëm "zjarr", për të fluturuar predha deri 26 km. Kështu do të shkruante Asllan Osmani, korrespondent rajonal i shtypit ushtarak që nuk iu nda grupit të veteranëve ato ditë që nga Tirana e kudo. Të nesërmen me datë 5 mars nisemi për Krumë, shkojmë më tej,

në Letaj, mu në kufi, ku njihemi drejtpërdrejt me situatën e datës 4 mars. Takohemi me banorë, (burra, gra, të rinj e te reja) të armatosur e të vendosur për të mbrojtur kufirin. Janë çaste emocionuese - edhe ata ndjehen të vlerësuar e të frymëzuar nga vizita e grupit të veteranëve. Në Lumë e Has veteranët u gjallëruan, vështronin me kujdes, bisedonin me përzemërsi dhe testonin. Diku pyesnin e shpjegonin. Oficerët dhe trupa dëgjonin me vëmendje. Sa hipnin në makina, veteranët fillonin debatet, përzgjidhnin pikat ku do të thellonin njohjen. Po dhe burra modest, të kulturuar e të sjellshëm. Pa mendjemadhësi e fodullëk. Largohen nga Kukësi të përcjellë me respekt e dashuri, po largohen vetëm fizikisht. Me shpirt janë aty. Ata kanë dhënë një ndihmesë me vizitën dhe me mendimet e tyre. Veç tjerash ata i kërkuar komandantit të divizionit të skalionoheshin më shpejt disa mjete e forca. "Situata nuk na duket se pret",

- thanë. Dhe ashtu doli. Sapo u largua misioni i OSBE nga Kosova, me 20 mars, serbët filluan në masë spastrimin etnik. Më 23 mars filluan sulmet ajrore 78 ditore të NATO-s mbi Jugosllavi. Në Tiranë grupi i veteranëve u prit nga ministri i Mbrojtjes zoti Hajdaraga, i cili i dëgjoji me vëmendje mendimet e tyre dhe i falënderoi Ju jeni pjesa më e depolitizuar e Forcave të Armatosura do t'u thoshte ministri ish-gjeneralëve, veteranëve të shquar të Luftës dhe të Ushtrisë. Edhe ata nga ana e tyre e falënderuan Ministrin dhe përgëzuan në veçanti Divizionin e Kukësit dhe komandantin e tij për punën që kishin bërë për ringritjen e divizionit pas ngjarjeve të vitit 1997, për gatishmërinë dhe për prirjen e tyre. Dhe në fakt Divizioni i kreu me nder detyrat në situatën e Luftës në Kosovë.

***Ish-drejtor i Departamentit të Veteraneve të Luftës, shoqërues i grupit të veteranëve në këtë aktivitet. Titulli është i redaksisë.**



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ
HISTORIAN USHTARAK

Gruaja shqiptare ka qenë pjesëmarrëse aktive në ngjarjet kryesore të historisë të popullit tonë. Në kohë lufte gjithmonë ajo ka luftuar me armë për të mbrojtur familjen dhe atdheun. Në historinë e luftërave shekullore të popullit tonë për liri e pavarësi, për ruajtjen e individualitetit të vet, për një jetë të lirë nga shfrytëzimi dhe padrejtësitë shoqërore, gruaja shqiptare ka luajtur një rol të rëndësishëm. Emrat e mjaft grave si: Teuta, Mamica Kastrioti, Nora e Kelmendit, Maro Kondi, Sevasti Qiriazit, Marigo Pozio, Shote Galica, Sado Koshena etj., e kanë emrin të skalitur me shkronja ari në historinë e Shqipërisë. Shtojmë se dëshmorja më e hershme e Atdheut është Maro Kondi, e cila daton që në vitin 1847, në kryengritjet kundër Tanzimatit. Në këtë histori shekullore të vendit tonë, roli i gruas shqiptare u shqua më shumë gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur Shqipëria ishte e pushtuar nga nazifashistët. Mbi 6000 gra dhe vajza dolën në këtë luftë, e dhanë kontributin e tyre për çlirimin e vendit. Ato thyen mjaft koncepte dhe u radhitën përkrah burrave në këtë epope, duke dhënë dhe jetën për çlirimin e vendit. Ato flakën tej zakonet dhe thyen tabutë e kohës, duke u bërë shembull frymëzimi në Luftën Nacionalçlirimtare. Një fakt me domethënie botërore është se në këtë luftë nga 5 heroina që u ekzekutuan në litar apo u dogjën nga nazifashistët gjatë Luftës së Dytë Botërore, 4 heroina janë shqiptare: Bule Naipi, Persefoni Kokëdhima, Hibe Palikuqi dhe Liri Gero. Në kohën kur vendi ynë u pushtua nga fashistët italianë në prillin e vitit 1939, së bashku me grupet e rezistencës morën pjesë dhe gratë shqiptare. Në ballë të gruas shqiptare u afirmuan intelektuale, por dhe mjaft gra të thjeshta në qytet e fshat, duke bërë qëndresë në forma nga me të ndryshmet. Qendra të rëndësishme të luftës ishin qytetet e mëdha të vendit, ku një rol luajtën shkollat në të cilat mësonin mjaft vajza. Kështu, instituti femëror në Tiranë u bë vatër e rezistencës kundër fashizmit. Të gjithë e kemi parë filmin artistik “Vajzat me kordele të kuqe”, ku i bëhet jehonë pjesëmarrjes masive të tyre në këtë luftë që sapo kishte nisur të organizohej në vendin tonë. Studentet brenda institutit ndërmerrnin veprime të tilla si: nuk ndërmerrnin në mënyrë fashiste, grisnin flamurin italian, thyenin fotografitë e Duçes etj. Në qytete e fshatra të Shqipërisë, format e qëndresës prej gruas ishin të ndryshme. Kështu gjimnazistet e Shkodrës morën pjesë aktive në demonstratën e madhe antifashiste të organizuar më 28 nëntor 1940. Kurse në Tiranë, studentet e institutit femëror prishën mbledhjen në përkujtim të marshimit fashist mbi Romë, të cilën e kthyen në një demonstratë në rrugët e Tiranës. Shumë prej tyre u përjashtuan nga shkolla e institutet. Midis vajzave të përjashtuara ishte dhe heroina Margarita Tutulani. Gruaja me prezencën e saj po luante një rol të rëndësishëm dhe me dinjitet e me vlera u rreshtua edhe ajo në Luftën Nacionalçlirimtare. Fillimisht për të rritur numrin e grave e të vajzave në këtë lëvizje u organizuan bërthamë të vogla të gruas. Gra e vajza intelektuale me autoritet e nisën punën e tyre në lagje e fshatra, duke formuar grupe të cilat shpërndanin trakte e komunikata të ndryshme për luftë. Këto mjekonin aktivitetë e partizanë të plagosur në aksionet e njësiteve dhe të çetave partizane, dhe shtëpitë e tyre u bënë strehë e u kthyen në vatra të rëndësishme të lëvizjes. Shumë gra në qytete bënë punë me shkollat, ku krijuan grupe dhe celula edukative, në të cilat kryeshin aktivitetet, diskutohej,



Kontributi i gruas, me vlera të mëdha gjatë LANÇ-it

lexoheshin komunikata dhe këndoheshin këngë patriotike. Në këtë lëvizje e cila po merrte përmasa, u bashkuan gra të profesioneve të ndryshme si infermiere, mësuese, shtëpiake etj. Femra shqiptare duke qenë shtyllë në familje, filloi të propagandonte luftën kundër pushtuesve. Ato punonin dhe shfrytëzonin festat tradicionale, merrnin pjesë në ekskursionet e grumbullime masive, mbledheshin dhe diskutonin për luftën, gatuanin dhe jepnin ndihma materiale etj. Vajzat në shkolla u përdorën si mjet propagandues, edhe në teatër, ku shfaqnin jetën, përpjekjet dhe luftën e tyre që bënin gratë në familje e kudo. Të gjitha këto forma, po bënin efekt të madh në popull dhe vet gruaja po fitonte vendin e saj në shoqëri dhe po e ndryshonte konceptin e gabuar që kishin shqiptarët në përgjithësi për të. Gratë e Kavajës në prill 1942, të mbuluara me çarçaf e perçe dolën bashkë me burrat e me të rinjtë në demonstratë për të kërkuar bukë. Ndërsa në Elbasan, më 8 gusht 1942, mjaft vajza morën pjesë në demonstratën e bukës. Haxhire Myzyri e Aleksandra Mano goditën majorin e xhandarmërisë fashiste. Një nga demonstratat më të përgjakshme ishte ajo në qytetin e Korçës, ku mbetën të vrarë 59 persona dhe u plagosën 93 të tjerë, shumica e tyre ishte gra. Gratë dhe vajzat nuk munguan në frontin e madh të luftës që u krijua kundër pushtuesve. Ato krijuan organizatën e tyre të gruas. Organizata e tyre i vuri vetes si qëllim pjesëmarrjen e saj në luftë, të ishte sa më e organizuar dhe në të ardhmen të merrte pjesë aktive në drejtimin e vendit. U krijua organizata Bashkimi i Gruas Antifashiste Shqiptare. Në të gjitha qytetet dhe krahinat u ngritën këshillat e grave antifashiste. Në Konferencën e Dytë Nacionalçlirimtare të mbajtur në Labinot të Elbasanit nga 4-9

shtator 1943, mori pjesë dhe një delegacioni i gruas shqiptare që përfaqësohej nga Ollga Plumbi, Ela Gjickoni dhe Nexhmije Xhuglini. Delegacioni i grave kërkoi në këtë mbledhje që Organizata e Gruas të njëhej dhe të bëhej pjesë e Frontit Nacionalçlirimtar. Kështu gruaja me plot dinjitet u rreshtua në LANÇ të popullit shqiptar. Në të gjithë vendin gruaja u përfshi masivisht në luftë. Organizata e gruas krijoi këshillat e saj dhe ato filluan nga zbatimi i detyrave dhe qëllimit që i kishin caktuar vetes në këtë luftë. Mjaft gra humbën jetën në krye të punëve që u ishin ngarkuar nga këshillat e tyre. Kështu Esmë Dervishi, anëtare e këshillit në Karbunarë e vranë se shkante në mal me ushqime, ndërsa Saretë Gabaj nga Smokthina, u kap nga nazistët dhe u torturua, ku u dogj e gjallë, sepse nuk dha informacion për partizanët. Organizata filloi punën në çdo krahinë dhe në terren, ku dhe kishte nevojë. Gra e vajza të tilla si Bule Naipi, nga Gjirokastra vepronte në Libohovë e Konispol, ku organizoi dhe ngriti aktive me gra dhe grupe edukative. Gra të tjera si Qeriba Derri kthehen nga emigracioni dhe bashkohen me lëvizjen antifashiste. Qeribaja ngriti organizatën e gruas në mjaft fshatra të Lumit të Vlorës. Në Operacionin e Dimrit 1944, ajo ndodhej bashkë me partizanët e Br. V Sulmuese, në malet e Çikës. Aty tregoi heroizëm, por u kap nga nazistët dhe burgoset në burgun e Vlorës, ku torturohet barbarisht, por informacion armikut nuk i dha, e kurrë nuk u dorëzua. Pushkatohet më 4 prill 1944. Organizata e gruas shtoi si nevojë të domosdoshme ngritjen e një organi shtypi, i cili do të shërbente më mirë çështjes kombëtare. Revista “Gruaja shqiptare” doli në dritë si organ i Bashkimit të Grave Antifashiste të Shqipërisë në korrik të vitit 1943. Si pasojë e kushte

të vështira të luftës vendi i botimit ndryshonte shpesh si pasojë e terrorit që ushtronin fashistët. Pjesëmarrja e grave me armë në dorë, pra në luftë nuk ishte një fenomen i panjohur. Në historinë shekullore të vendit tonë, në periudha të ndryshme në shumë luftëra për tokë, liri e pavarësi që ka zhvilluar populli ynë, gratë kanë marrë pjesë krah përkrah me burrat dhe kanë luajtur një rol të rëndësishëm. Në kushtet e Luftës Antifashiste, gruaja u dallua për masivitet, shkallë të ndërgjegjshme, kompaktësi dhe organizim në shkallë kombëtare. Pjesëmarrja e gruas në luftën e armatosur, ndeshi në pengesa dhe vështirësi. Ende nuk ishte krijuar opinioni shoqëror për rolin e saj në Luftën Nacionalçlirimtare. Vetë gruaja duhej t’u kundërvihej mentaliteteve dhe koncepteve të shumta konservatore, prapanike, patriarkale, që vinin nga e kaluara. Gradualisht, ajo fillon të jetë aktive në luftën e popullit kundër pushtuesit. Kryerja me sukses e disa aksioneve dhe goditjeve të shpeshta të forcave partizane kundër pushtuesit fashist në krahina të ndryshme të vendit, bëjnë që këto zona të ishin të çliuara. Pjesëmarrja e gruas në luftë pati rëndësi vendimtare jo vetëm për fatet e Luftës Nacionalçlirimtare, por dhe për vetë gruan. Ajo ishte forcë e rëndësishme shoqërore dhe përbënte gjysmën e popullsisë. Gruaja duke marrë pjesë në kryengritjen e armatosur, vihej në kushte të barabarta me burrin, për sa i përket të drejtave e detyrave ndaj Luftës Nacionalçlirimtare. Pjesëmarrja e gruas në luftën e armatosur tronditi botëkuptimin borgjez, konceptet dhe paragjykimet mbi rolin dhe pozitën e saj në shoqëri. Ky botëkuptim dhe këto koncepte ishin kultivuar në shekuj. Pjesëmarrja e gruas në luftën e armatosur hodhi tej propagandën fashiste, e cila përpjetej t’i mbante gjallë e t’i ushqente koncepte frenuese. Fakti që gruaja ishte në gjendje

të përballonte me sukses të gjitha pengesat e vështirësitë që sillte me vete lufta e armatosur, shkatërronte mitin, sipas të cilit gruaja si “seks i dobët” “ishte e destinuar gjoja vetëm për të lindur e rritur fëmijë”, por, “aspak e aftë të luftonte si burri me armë në dorë dhe aq më tepër për luftën partizane”, koncept ky i rrënjësor thellë në vetëdijen e shumë njerëzve, si të burrave ashtu dhe të grave. Duke e parë luftën dhe problemin nga shikimi, dalja partizane kishte më tepër rëndësi për gruan sesa për burrin. Për të arritur deri aty, sa të rrëmbenin pushkën, grave e vajzave në përgjithësi iu desh të luftonin në disa drejtime: nga njëra anë duhej t’i bënin ballë presionit të madh e të vazhdueshëm të propagandës armiqësore të pushtuesit fashist dhe reaksionit të brendshëm dhe nga ana tjetër, të mposhtnin pengesat dhe vështirësitë që u nxorën në mjaft raste vetë prindërit e njerëzit e tjerë të familjes dhe sidomos opinionin shoqëror. Në LANÇ një numër i madh grash u rreshtuan në njësitë dhe formacionet e ndryshme të UNÇSH. Grave e vajzave ju ngarkuan detyra të rëndësishme si komandante e komisare, përgjegjëse të rinisë dhe të grave në formacione të ndryshme si në kompani, në batalion e në brigada sulmuese. Rol të rëndësishëm kanë luajtur gratë që ishin në detyra dhe përgjegjësi në seksionet politike të brigadave e divizioneve sulmuese. Kështu gra të tilla si: Eleni Terezi, Fiqirete Sanxhaktari, Vangjelo Sotiriadhi, Ramize Gjebreja, Urani Prendi, Liri Hakani etj., kanë pasur përgjegjësi në radhët e UNÇSH. Kështu, në mjaft brigade sulmuese, si në Br. III, V, XX, XVIII S, gratë dhe vajzat që ishin në detyra zinin mbi 30% të numrit të tyre. Në 13 brigada partizane, rreth 100 gra e vajza kanë qenë përgjegjëse rinie brigade, batalioni e kompanie, si dhe mbi 47 prej tyre kanë qenë në detyra komisare e zëvendëskomisare batalioni e kompanie. E rëndësishme të theksojmë në këtë shkrim historik është se mjaft gra e vajza arsimtare ishin të lidhura me lëvizjen, e dhanë një kontribut të vlefshëm. Në Kongresin e Parë të Bashkimit të Gruas në nëntor 1944, u shpall kontributi dhe heroizmi i treguar nga gratë dhe vajzat shqiptare në luftën kundër pushtuesve nazifashist dhe bashkëpunëtorëve të tyre. Një pjesëmarrje e tillë e organizuar, nuk ishte vërejtur më parë gjatë historisë tonë. Vajzat dhe gratë shqiptare u bënë shembull frymëzimi për guxim e trimëri, për ndershmëri e pastërti morale e shpirtërore, si dhe për forcimin e marrëdhënieve vëllazërore në radhët e luftëtarëve të lirisë. Për aktet e larta të trimërisë dhe të vetëmohimit mjaft gra dhe vajza u shpallën heroina të Popullit si: Bule Naipi, Persefoni Kokëdhima, Liri Gero, Margarita Tutulani, Shejnaze Juka, Mine Peza, Hibe Palikuqi, Nimete Progonati, Inajete Dumi, Zonja Çure, Qeriba Derri, Fato Berberi, Qybra Sokoli, Ylber Belibashi, Shenjaze Juka, Emine Peza, etj. Pjesëmarrja e gruas në Luftën Nacionalçlirimtare, nuk ishte vetëm kushti vendimtar për çlirimin kombëtar e shoqëror të saj. Në të njëjtën kohë kjo luftë shërbeu dhe si një shkollë e madhe për emancipimin shpirtëror të gruas shqiptare. Duke marrë pjesë aktive në të gjitha format e luftës e të organizimit, deri në kryengritjen me armë, gruaja shqiptare theu mjaft koncepte e praktika të vjetra dhe afirmoi veten e saj të denjë për një shoqëri të lirë dhe demokratike. Në saj të kësaj lufte dhe të përpjekjeve të vijueshme të bëra në këto 70 vjet pas lufte, ajo sot është më tepër e organizuar dhe po zë një vend të merituar në të gjitha shtresat e shoqërisë demokratike shqiptare. Fakt është se gruaja shqiptare sot është pedagoge, deputete, ministre, biznesmene, diplomate, oficerë, police, drejtuese institucionesh etj. Vetë lufta, kuraja dhe përpjekjet e saj në shoqëri e kanë radhitur atë të barabartë me burrat, dhe sot gëzon të drejta të plota, të njohura botërisht dhe të garantuara me ligje e kushtetutë.

2 mars 1444, Besëlidhja e Lezhës



*Mars 2014,
570-vjetori i Kuvendit
të Lezhës, kuvend i
cili bashkoi shqiptarët
në luftën kundër
pushtimit osman*

